



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **26.12.2019**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatoi se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar **Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi**, Nën kryetar i Komunës **z. Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtore të drejtorive komunale, përfaqësues të KKS-së, KFOR-it, media, dhe ju gjithë të pranishëm!

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë :

REND DITE

RAHOVEC /ORAHOVAC	
Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)	
Nr./Br./No <u>01/35</u>	Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>20</u>
Data/Datum/Date <u>30 / 01 / 2020</u>	

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi i raportit rreth aktiviteteve të KKS-së për vitin 2019,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) për vitin 2020,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit paraprak për shpalljen e interesit të përgjithshëm për hapjen e rrugës publike në Z.K – Xërxë,
6. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2019,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2020,
8. Shqyrtimi i Raportit mbi realizimin e Planit për vitin 2019 si dhe shqyrtimi i Planit të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2020,
9. Shqyrtimi i Raportit mbi realizimin e Planit për vitin 2019 si dhe Informatë mbi Planin vjetor të Zyrës së Prokurimit publik për vitin 2020,
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për vënien në debat publik të Planit Lokal për Veprim në Mjedis 2019-2024,
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për vënien në debat publik të Planit Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë 2019-2020

Kryesuesi- Te nderuar kuvendarë, a jeni për këtë rend dite. Konstatohet se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar - A ka dikush diçka rreth procesverbalit, nëse nuk ka atëherë e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve –

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, Kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit komunal, drejtorët, përfaqësuesit e LMT-së, OSBE-së, mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë desha me ngrit një shqetësim të qytetarëve lidhur me një çështje rreth defekteve që shkaktohen nga uji i pijes, pra është mirë Kryetari i Komunës gjegjësisht komuna e Rahovecit me fol me Ujësjiellësin “Radoniqi”, në mënyrë pak më serioze, në mënyrë që kur vjen deri te sanimi i defektit që është në ato pjesë ku ndodh defekti, të kthehet në gjendjen paraprake pra ekzistuese ashtu siç ka qenë, kemi disa raste unë personalisht i kam pyet se a duhet ta rregulloni ashtu siç ka qenë, ata thanë se është e vërtetë por ne nuk kemi mundësi më tepër, vetëm e hapin gropën e evitojnë defektin edhe asgjë tjetër pra është mirë ata të kenë një kamionetë po ashtu edhe zhavorrin edhe ta kthejnë në gjendjen paraprake kështu që është mirë komuna me insistua në këtë drejtim sepse me të vërtetë rrugët janë dëmtuar shumë me këto defekte që po ndodhin, kjo është një shqetësim, pastaj kemi segmentin e rrugës Fortesë- Celinë të cilën e kemi ngrit shumë herë këtë çështje që është në gjendje mjaftë të keqe pra është mirë që në dy apo tre vende deri sa të vjen mundësia ndonjë herë tjetër me i rregulluar mirë këto gropa se më të vërtetë janë bërë të pakalueshme sepse me vështirësi kalohen me makinë po ashtu në të njëjtën rrugë është një shqetësim për mua edhe qytetarët sepse edhe jemi të pandërgjegjshëm ndoshta se dikush ka vendosë dhe, ose janë mbledhë mbeturinat edhe po e bllokojnë daljen e ujërave kështu që do ishte mirë një eskavator t’i heq ato në pjesën e poshtme ato pengesa në mënyrë që kur bie shi apo ngjashëm, që uji të kalon dhe mos të mbetet uji në asfalt sepse ka vazhdimisht ujë aty kush e frekuenton atë pjesë e sheh këtë problem. Ju faleminderit!

Masar Popaj – Përshëndetje për të gjithë, unë i kisha dy pyetje, e para është me datë 02.12.2019, pash gurë themelin në fshatin Koznik dhe desha të pyes drejtorin e drejtorisë së Arsimit z. Avni Morina, atë ditë kur vunë gurë themelin e shkollës fillore “Milaim Krasniqi” nuk e pash asnjë nxënës në pjesëmarrje, arsyeja pse nuk kishte nxënës që pres përgjigje nga drejtori dhe shuma e projektit ishte 79,857 euro, pyetja e dytë ishte për drejtorin për punë inspektuese z. Besnik Hoti, përgjatë rrugës Fortesë-Xërxë pra rrugës kryesore ne toka bujqësore janë mbushur me varreza të automjeteve, e pyes drejtorin që a i ka inspektuar dhe sa kanë të drejtë të ushtrojnë këtë veprimtari? Faleminderit!

Ali Morina – Faleminderit Kryesues, i nderuar Kryetar, drejtor të drejtorive, te nderuar kolegë, përfaqësues të KFOR-it, unë desha të ngris një shqetësim të një komuniteti goxha të gjerë siç janë shoferët qoftë të autobusëve, kamionëve por edhe ne që përballemi çdo ditë në rrugë tona, fjala është për sinjalistikën e rrugëve magjistrale dhe rajonale, unë e di që kjo është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës por Komuna duhet të ushtrojë tryzni të vazhdueshme që të pajisen këto rrugë me sinjalistikën e duhur, shihet që mungon vija ndarëse në mes të dy shiritave dhe mungojnë vijat anësore pastaj shenjat vezulluese anash edhe aty ku janë nuk e kryejnë funksionin që janë rrëzuar ose janë të papastra nga balta apo nga pluhuri. Ne tani jemi në sezonin dimëror, tani është edhe vonë për t’i kryer këto punë mirëpo vërtet përballemi më vështirësi kur ka mjegull ose të reshura atmosferike, unë jam në dijeni se ekzistojnë inspektorët rajonal të Ministrisë që kanë për detyrë t’i inspektojnë këto rrugë ku ka defekte apo pengesa për me t’i evituar ato mirëpo nuk e di a janë duke e kryer punën ata apo jo. Faleminderit!

Fehmi Cena - Faleminderit Kryesues, përshëndetje për juve, për Kryetarin, kolegë asambleistë, drejtorët, monitoruesit dhe gjithë të pranishmit në këtë sallë. Unë desha me ngritë një çështje në lidhje me një shesh këtu në qytetin e Rahovecit, është fjala për sheshin mbi shkallët në qendër me emrin e vjetër Sheshi i Grëdinës, i cili është shtruar me kocka guri, është një krua publik që është rregulluar sivjet mirëpo është vendosur një pllakë te ai sheshi, pra te kroi me emrin e Hajredin Pashës dhe banorët e lagjes po pyesin, kush e ka vendos atë pllakë duke e ditur se ai shesh nuk e ka atë emër, nëse veç duhet të ekzistojë një pllakë aty atëherë le të jetë me emrin e sheshit që është siç quhet ai shesh mendoj se është e udhës që me u bo ky ndryshim. Faleminderit!

Dervish Çadraku – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne fakt unë e kisha një pyetje për drejtorin e Arsimit, por edhe pse kisha mundur ta bëj këtë pyetje edhe pa prezencën e Kuvendit por e kemi bërë praktike për çfarëdo që kemi po pyesim edhe në Kuvend, por unë e kam më shumë për Kryetarin tani drejtpërdrejtë, sepse unë jam i bindur se drejtori i Arsimit e dinë problemin që po dua ta them pra është fjala për shkollën fillore, paralelen e Malësisë së Vogël në Gexhë. Nuk di kryetar a e keni shikuar dhe a keni hyrë brenda se ajo është totalisht gati e demoluar d.m.th. ka rrjedhje të ujit neper të gjitha anët nëpër klasë, pjesa e jashtme është e dëmtuar, unë nuk them se nuk ka edhe ndonjë shkollë tjetër kështu mirëpo unë nuk mendoj që ka në komunë tonë shkollë me të dëmtuar se sa ajo, dhe disa e herë shkojmë e vizitojmë mirëpo nuk ka asnjë veprim konkret, aty janë të dëmtuara edhe dritaret dhe tash ky dimër që hymë tash është i rrezikshëm për fëmijët sepse aty do të krijohet një atmosferë shumë e rëndë nga të ftohtit edhe unë mendoj se tash është problem me intervenuar në kulmin e saj, sepse kulmi është totalisht i dëmtuar dhe ujërat e shirave, pra të reshurave krejt futen brenda, unë i kam edhe me fotografi këtu mirëpo nuk po dua me i vërtetua unë, sepse më mirë është vetë të shkonë atje dhe t'i vërtetoni edhe me marr një aktivitet sa më shpejt që është e mundur sepse më të vërtetë janë në një gjendje të rëndë. Faleminderit!

Munib Durguti – Faleminderit Kryesues, përshëndetje për Kryetarin, për kolegë asambleistë, përfaqësuesit e mediave. Pyetja e parë ka të bëjë rreth procesverbalit i cili aplikohet tash e një kohë me vite në Kuvend, unë propozoj që në vend të transkriptit i cili përshkruhet për çdo fjalë që bëjmë fjalim këtu apo ngrisim çështje, që t'i japim një liri procesmbajtësit që t'i nxjerr vetëm kuptimet e fjalëve dhe ajo të jetë një procesverbal i shkurtuar. Unë besoj që është e panevojshme që neve të na servohet në çdo seancë procesverbali aq voluminoz, ky nuk është procesverbale por ky është transkript. propozoj që transkripti të incizohet dhe të vendoset nëpër Cd-të apo Dvd-të dhe të jetë në dosjen e Kuvendit ndërsa neve të na vjen një procesverbal d.m.th. me kuptime për atë çka kemi folur, për shkak se ndodh ndonjëherë që flasim gjatë mbi 15 minuta dhe është e panevojshme që secila fjalë të përshkruhet në procesverbal pra ky është propozimi i cili do të kisha dëshirë që të hedhet në votim nga asambleistët qoftë në një seancë tjetër por të merret parasysht. Edhe e dyta është rreth trotuareve që i shfrytëzojmë në qytet sidomos, propozoj që të rishikohen të gjitha lejet që janë dhënë kafiterive për shfrytëzimin e trotuareve për vendosjen tavolinave jashtë. Rruga. “Xhelal Hajda” prej semaforëve e deri te Stacioni i Autobusëve, besoni që është e pakalueshme për këmbësorë shkaku i këtyre tavolinave që i nxjerrin jashtë sidomos verës. Është një gjendje shumë alarmante edhe duhet të shqyrtohet prej Kuvendit, nëse ka nevojë për ndërhyrje në rregullore apo duhet të bëhen të gjitha ndërhyrjet që të tërhiqen ato vendimet për shfrytëzimin e trotuareve. Po ashtu pengesat që janë vendos në bashkëfinancim vite me parë me një organizatë, besoj që është koha edhe ato të ndryshohen, të ngushtohen pengesat dhe sipas mundësive të shpeshohen, në mënyrë që të jemi të sigurt që vetëm këmbësoret të jenë shfrytëzues të atyre trotuareve të cilët edhe ashtu janë shumë të ngushta. Ju faleminderit shumë!

Ali Zhuniqi – Përshëndetje Kryesues, për të gjithë të pranishmit, unë e kam një shqetësim në lidhje me konkursin i cili së fundi është mbajtur për dy profesorët që kishte dalë konkursi për zëvendësimin që kanë shkuar në pushim të lehonisë, ne njërin konkurs në Matematikë është shpallur në web-faqen zyrtare sipas rregullave dhe kornizave ligjore ndërsa për një konkurs tjetër për një profesoreshë të lendës, drejtimi juridik që posedojmë informacione që vjen një profesoreshë nga komuna e Prizrenit dhe vjen menjëherë në shkollë profesionale për orët që duhet zëvendësuar për shkak të pushimit të lehonisë që ka marrë tjetra profesoreshë, i drejtohem drejtorit të Arsimit nëse kjo është e vërtetë, pse nuk është mbajtur konkurs për atë sikurse është mbajtur për profesorin e Matematikës për zëvendësim dhe nëse jo atëherë pse i mban për arsye se bien në kundërshtim me kornizat ligjore.

Fahrie Lushi – I nderuar Kryesues, i nderuar Kryetar, të nderuar kolegë këshilltarë dhe gjithë të pranishmit. Unë do të ndërlidhesha pak me dhënien e çmimit Sylejman Krasniqi, thjesht do të kërkoja sqarime nga Fjolla meqë ka qenë anëtarë e jurisë jo vetëm për mua por që të jetë motivues ky çmim edhe për ata që do të konkurrojnë edhe vitet e ardhshme sepse nuk kam asgjë kundër Blerta Nallit e askujt tjetër mirëpo do të ishte mirë edhe për opinionin edhe për ata që do të konkurrojnë vitet e ardhshme që t'i motivonin duke shpjeguar

mënyrën se si konkurrohet, a konkurrojnë me emër apo me kode të caktuara sepse të mos japim hapësirë konspiracioneve e polemikave të tjera, kërkoj që Fjolla të na shpjegojë këtë. Faleminderit!

Fehmi Hoxha – Përsëritet z. Kryesues, Kryetar, ekzekutiv, kolegë kuvendarë, media, përfaqësues të LMT-së dhe gjithë të pranishëm. Ne vitin 2016 trupi vendimmarrës i atëhershëm pra Kuvendi komunal i Rahovecit pas hartimit dhe propozimit të planit të mobilitetit nga ana e ekzekutivit të mëparshëm, e ka miratuar planin e mobilitetit në këtë sallë. Është obligim i qeverisë aktuale që të zbatojë planin e mobilitetit i cili është i miratuar nga vendimmarrësit në Rahovec. Çështja është që pas atij plani të mobilitetit duhet të fokusohemi në investimet dhe hartimi i buxhetit edhe investimet kapitale kryesisht e kam fjalën për qytet. Në disa rrugë sipas planit të mobilitetit të cilën e keni, jo që patjetër e keni t'i referoheni atij plani për investime që ndërlihet edhe me vërejtjet që i dha z. Durguti më herët është paraparë me ndalimet ne rrugën Xhelal Hajda dhe në rrugë tjera, ku këto vend ndalimet ndihmojnë shumë edhe bizneseve njëkohësisht do të jetë rruga shumë me funksionale jo parkingje por vend ndalime, kështu që kërkoj t'i referohemi atij plani të mobilitetit që është marrë vendim nga Kuvendi Komunal dhe të zbatoni atë në përpikëri, nëse keni ndonjë ndryshim eventual atëherë mund ta hedhni në Kuvend edhe ky trup me marr vendimin për ndonjë ndryshim përndryshe keni obligim ta zbatoni planin e mobilitetit. Faleminderit!

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, unë desha me fol diçka në lidhje me diskutimin e kolegut Munib Durguti që propozoj me shkurtua procesverbalin, thjesht me i dhënë kuptimin, nuk kam asgjë kundër asaj ndoshta do të ishte më mirë edhe me lehtë për ata që e bëjnë por jam i shqetësuar që në bazë të praktikës se mëparshme kemi pasur vërejtje gjithmonë prej anëtarëve të Kuvendit që jo nuk i ke shkruajtur këto fjalë, jo unë kam thënë kështu apo ashtu edhe dyshoj në atë se do të zgjatet me shumë pastaj puna kështu që duke menduar mos po bëjmë diçka më mirë, e po bëhet më keq pra vetëm këtë shqetësim e kam, përndryshe nuk më pengon që të jetë ashtu apo kështu por këtë shqetësim e kam edhe besoni që do bëhet prapë edhe do të thoni se kam folur kështu edhe nuk i ke shkrujtë fjalët të cilët i kam thënë edhe lindin probleme më të mëdha kështu e bëjmë si të doni, e analizojmë si Kuvend dhe mendoni. Faleminderit!

Hanalora Hoti – Faleminderit Kryesues, të nderuar të pranishëm, i nderuari Kryetar, unë desha të bëj një pyetje lidhur me dekorimet në qytet që janë bërë, desha me pyet pse janë vendos shumë vonë ato dekorime edhe kemi parë që nëpër rrjete sociale i kanë marrë si tallje sepse edhe cilësia e tyre edhe u dukeshin mos të them shumë keq, vërtet e kanë marr si tallje neper rrjete sociale kur e dimë se për to është ndarë goxha një shumë jo edhe e vogël e të hollave, unë desha një shpjegim të dimë dhe t'i informojmë qytetarët për këtë. Faleminderit!

Refki Kryeziu – Faleminderit Kryesues, përsëritet për të gjithë, unë desha të ngris një shqetësim të banorëve të fshatit Xërxë, rruga Nëna Tereza ka dy muaj që ka filluar të rregullohet dhe është ndërprerë dhe askush nuk merret me këtë problematikë dhe një çështje tjetër që është një shqetësim i banorëve të fshatit Pataqan i Epërm, përroi që kalon në mes të fshatit që gjatë të reshurave atmosferike ai del jashtë shtratit dhe hyn nëpër oborret e banorëve. Ka qenë edhe një premtim i Kryetarit që shtrati i përroit të fshatit Pataqan i Epërm të rregullohet. A ka ndonjë plan për këtë çështje? Faleminderit!

Fjolla Duraku – Faleminderit kryesues, përsëritet për të gjithë, e nderuari Fahrie Lushi, unë dua të flas vetëm në kornizat të cilat mua më takojnë pra si një anëtare e jurisë dhe jo si një organizatore e dhënies së çmimit. Unë dua të shpjegoj se ne kemi qenë tre anëtarë dhe kryetarja është Besa Hoxha e cila i ka të gjitha detajet që i kam pasur edhe por jo tani me vete. Të gjithë që shkruajnë janë të motivuar natyrisht, Blerta ka qenë poetja me një poezi që ka qenë më e mira nga të gjitha shkrimet tjera jo nga një analizë subjektive, e kemi bërë një analizë objektive ku i kemi analizuar të gjitha figurat që duhet t'i ketë një poezi që janë figurat stilistike, i kemi pasur edhe fjalët pra leksemat, ka pasur një leksemë të pastër dhe gjithashtu natyrisht të pasur, po t'i merrni edhe shkrimet tjera edhe t'i analizoni si një letrare do të bindeni edhe vetë meqë edhe poezinë e keni lexuar. Faleminderit!

Kryetari – Faleminderit, përsëritet për Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, për anëtarët e kuvendit, drejtorët e drejtorive, përfaqësuesit e KFOR-it pra të LMT-së, mediat dhe gjithë ju që jeni të pranishëm. Ndoshta nuk më takon me plotësua Fjollën por atë ditë kam dëgjuar se ka shkuar me kod, unë nuk e di asnjë

detaje nuk e di por ato që kanë shkruar të gjitha kanë qenë me kode, kushdo që është paraqitur aty, së paku arsyetimin E Besa Hoxha-Beqiri e kam dëgjuar këtu në foltore, ndoshta ka nevojë ende me u sqarua mirëpo unë po besoj që kodi ishte që ka mundur me dit vetëm kryetari i jurisë, jo kodin fitues pra kodet i kanë pranuar vetëm juria dhe nuk besoj që dikush tjetër ka mundur me pas çasje, unë po besoj që reagimet janë të natyrshme, po besoj që juria ka pasur reagim profesional me bë vlerësim po ashtu profesional, si do qoftë unë nuk kisha dashtë me zgjatë më shumë për këtë çështje. Defektet nga KRU-Gjakova që Rasim Fazliu ka shtruar një çështje, ne dimë që kemi problem pasi veprimet që i ndërmerr KRU-Gjakova ose Radoniqi siç i kemi thënë dhe pamundësia ose vonesat në rikthimin e gjendjes së mëparshme. Ata kanë kontrata me kompanitë që pastaj i ndërmarrin veprimet e caktuara për me i rikthyer në gjendjen e mëparshme që po kemi probleme gjithandej sigurisht në Celinë, Krushë, në Rahovec pra nëpër rrugë kryesore, rrugë lokale e bile edhe në rrugë rajonale, në rastet si rruga për Krushë të Madhe prej Rahovecit këndeja ka Brestoci apo edhe rruga Gradish-Kramovik kemi pasur raste të tilla. Ne kemi bërë presion edhe unë përsëri po them që ne kemi arsye edhe me shumë me bë presion që ata me i shpejtuar punimet për shkak se nuk po del mirë ajo punë edhe po kemi vështirësi. Gropat në rrugën Fortesë-Celinë po ashtu mbeturinat në këtë rrugë, pra shqetësimet që i ka ngrit anëtarë i Kuvendit Rasim Fazliu është e vërtetë se unë i kam lutur disa kompani që me hedh rërë apo zhavorre për t'i trajtuar ato gropa që janë aty dhe i kam shikuar se ka edhe veprime subjektive të njerëzve të caktuar që ose e kanë mbyllë vijën ose ka hedh mbeturina që ka krijuar pengesë skaj rrugës që uji nuk ka nga të shkoj, pak është situatë jo e punës që nuk na bën krenar askënd dhe as neve si komunë e as ata që i bëjnë ato veprime ndoshta me shpëtuar arën e vet mirëpo duke e dëmtuar edhe rrugën por edhe plot gjëra tjera. Unë do të lus prapë për shkak se disa nuk isha edhe shumë i përqendruar në këtë pjesë, unë do të bisedojë dhe do të lus se a do të kemi mundësi bile së paku me bë më të përshtatshme dhe më të kalueshme rrugën Fortesë-Celinë po ashtu do të lusë kompaninë që të heq bërllokun që është bash përkaj rrugës diku mes Fortesës dhe Celinës.

Gurë themeli i shkollës në Kaznik, i nderuari Masar Popaj, është e vërtetë që nuk kishte nxënës atë ditë, mësimdhënës apo dikush tjetër, përafërsisht 2-4 banor të Kaznikut ishin prezent, po ashtu është e vërtetë që ai vend nuk ka shumë nxënës që drejtori i Arsimit mund ta di saktë se sa nxënës, kanë të drejtë njerezit të hapin dilemën a ka nevojë me pas investim në ndërtimin e një shkolle apo jo, mirëpo po të me pyetni mua ndoshta nuk ka shume nevojë por për banorët e Kaznikut duhet patjetër të ndërtohet shkollla sepse ata mendojnë se një shkollë me dy klasë dhe me një zyrë të mësimdhënësve, nuk është kontratë e madhe por kemi qenë të obliguar vërtetë me bo diçka sepse aty ku i kanë zhvilluar mësimet ata, kushtet ishin të vështira sikur një stallë se sa një objekt ku kanë vijuar ata 20 nxënës, një pjesë e nxënësve shkojnë në shkollën amë "Milaim Krasniqi" në Pastasel, edhe të shohim tash ne veç kemi filluar aktivitetin, banorët aty nuk ishin të informuar realisht se ne do të fillojmë për shkak se kontrata u lidh vonë por shqyr me të hyra vetanake dhe nuk kemi bërë ndonjë lajm që me i thirr ata banorë që janë të asaj pjese, madje as drejtori i shkollës në Pastasel nuk është lajmëruar fare për shkak se u deshtë me ja nisë punës për me vendos gurë themelin edhe me i kryer disa punë teknike sepse ishte kohë e keqe edhe u bë ftohtë dhe këto ishin arsyet, ndoshta do ishte mirë me i sjell nxënësit aty qoftë të Kaznikut që shkojnë në Pastasel qoftë edhe ata që shkojnë në Kaznik.

Varrezat e automjeteve në rrugën Fortesë- Xërxë, unë i kam angazhuar vetë inspektorët sepse edhe për mua është shqetësuese, ka një udhëzim administrativ që thotë çka është mbi 20 automjete është krejtësisht kompetencë e inspektorëve të shtetit, edhe çështja që unë e kam shtruar te drejtori dhe te inspektorët është se pse duhet me u lejua me u bë 20 makina pra para se te bëhet ky numër, ne duhet me operua e realisht ne jemi të vetëdijshëm se e kryen punën ata inspektorët por unë vazhdimisht jam i pakënaqur për shkak se nuk e japin maksimumin inspektorët edhe besoj që ju e dini se i paguaj edhe me punë shtesë që kemi organizuar edhe kujdestari edhe ditëve të vikendit pra sipas ligjit paguhet edhe me ka 120 euro më shumë. Ka përmirësime të kualitetit të veprimeve të tyre, ka disa rezultate mirëpo nuk janë ato rezultate të cilat ne i presim edhe qytetari i pret prej inspektoreve. Normalisht disa veprime të inspektoreve nuk janë krejt tanëve ose veprime sanksionuese për shkak se ndërlidhen me inspektorët e nivelit qendror, pra sidomos kjo e varrezave të automjeteve është e nivelit qendror. Ky është arsyetimi zyrtar, unë prapë kam insistuar edhe në emër të gjithëve sepse ato varreza që janë në rrugën Fortesë- Xërxë po ashtu edhe ne qytet kemi, vërtetë nuk e di por

është bërë njëfarë rutine që hajt se ashtu jemi mësuar t'i shohim edhe unë do të përpiqem me përdor autoritetin ligjor për me i krye disa veprime të cilat e bëjnë pak më të mirë këtë vend. Ali Morina ka pyetur të shenjëzimi i rrugëve, është e njëjta situatë, janë veprime të cilat duhet t'i ndërmerr për sa i takon shenjëzimit horizontal dhe vertikal të rrugëve rajonale dhe magjistrale. Totalisht jam i pakënaqur me këtë pjesë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe të Transportit, nuk e di a kanë kontrata apo jo, por janë disa rrugë madje rrugë të rëndësishme fatkeqësisht edhe rruga Prizren - Gjakovë, mos të flasim për këto rrugët rajonale që janë Gradish - Kramovik apo Rahovec - Xërxë apo Rahovec - Malishevë apo Rahovec - Krushë e Madhe. Pra janë pothuajse të pa shenjëzuara dhe nuk vërehen d.m.th. ne mund të i drejtohem përsëri Ministrisë së Infrastrukturës por nuk është kompetencë e jona. Është e vërtetë se ne çalojmë pak edhe ne shenjëzimin e rrugëve lokale, për shkak të pamjaftueshmërisë së buxhetit d.m.th. ne kemi një kontratë por nuk kemi mjete të mjaftueshme financiare edhe ka operator që duan me krye punën por ka edhe të tillë që nuk duan, se kemi edhe sfida të shenjëzimit të rrugëve lokale. Fehmi Cena ka pyetur për Hajredin Pashën. Ai personi me emrin Hajredin e ka vendos pllakën vet që u bo problem edhe në debat publik. Sipas potencimit të tij që i ka thënë Nënkrjetarit Fatmir Iska se krejt lagjja me thonë Hajredin Pasha edhe nuk kam dëshirë me heq këtë pllakë në murin tim. Sheshi nuk e ka emrin Hajredin Pasha, ai ka bërë lutje edhe individualisht ka ardhur në objektin e Komunës edhe i ka thënë Nënkrjetarit që të mos hiqet sepse nuk mundem ta paramendoj veten pa atë pllakë aty të vendosur sepse krejt më kanë thënë prej fëmijërisë edhe vet e kam ble edhe vetë e kam vendosë. Në e dimë që ju ka ekspozuar edhe pronës publike mirëpo nuk e ka qitë ndonjë kompani apo diçka të tillë, ai e ka pas edhe në një vend tjetër të një Krua edhe nga aty e kemi hequr edhe i kemi tërheq vërejtjen që të mos vendoset mirëpo ai përsëri e ka vendosë. Më të vërtetë është paksa interesant kjo punë sepse Hajredin Pasha nuk ka histori të mirë se paku me shqiptaret sepse e ka humb betejën në Dibër atje edhe i këndohet edhe kënga por para dy dite ishte në zyrë sepse ka dëgjuar në debat publik se u ngritë kjo çështje nga Shaip Shala, me shqetësim ka ardhur edhe është lutur që të mos hiqet sepse e kam vendosur vetë, ai ndoshta pretendon që të vendoset emri sheshit pas vdekjes së tij por besoj që do të zgjidhim këtë çështje por mos të harrojmë se nuk është investim publik, nuk është kontratë e komunës së Rahovecit sepse nuk e ka vendosur ndonjë kompani por e ka hedh vet, e ka ble vet edhe e ka vendos vetë.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, nuk e kam ditë që është debatuar kjo në shesh mirëpo unë kam dalë aty edhe kam biseduar me disa njerëz që rrinë aty në atë shesh edhe ata e shprehin këtë shqetësim, përndryshe nëse ai zotëria pasi kjo është private dhe nuk është ajo pllakë e vendosur në murin e tij, nuk kam asgjë kundër nëse ishte e vendosur në murin e tij por është te kroni dhe komuna le ta vendos pllakën e sheshit me emër, le të rrinë edhe ajo pllakë nuk prish punë asgjë por pllaka origjinale legale do të ishte me emrin e sheshit, kjo do të ishte detyrë e komunës për të treguar efektin e vet të pushtetit, pasi ai po e tregon efektin e vet si person edhe pushteti duhet të tregoj efektin e vet. Faleminderit!

Kryetari – Ashtu është, ne do të analizojmë këtë çështje, e di që është bërë problem edhe në debat publik.

Dervish Çadraku – Ju jeni Kryetar i Komunës dhe jeni kompetent edhe përgjegjës bashkë me institucionet që sheshet dhe vendet publike janë në kompetencat tuaja, dhe tash nuk është e drejtë se kujt t'i tekton me vendos aty poshtë e lart. Në oborrin tim unë mundem me vendos çka të dua por jo me vendos Hajredin Pashën në vendet publike kur e dimë se Hajredin Pasha është një kriminel që ka vrarë shqiptarë dhe me vendos tash emrin e tij në shesh, kjo është diçka serioze që duhet urgjentisht të hiqet si p.sh. emrin e një gjenerali të Millosheviqit me e vendos në Krushë apo diku tjetër. Faleminderit!

Kryetari – Edhe Dervish Çadraku edhe të gjithë e dinë se mua nuk më mungon guximi dhe as nuk me ka munguar kurrë, edhe detyrat e mia besoj që i kam të qarta si kryetar komune edhe ai nuk e ka vendos aty për atë Hajredin Pashën e të kaluarës por sepse vet e ka emrin Hajredin edhe ashtu ka pas qejf edhe sigurisht do të trajtojmë këtë situatë dhe mos ta bëjmë temë dhe nuk është ndonjë problem që ne nuk mundemi me zgjidhë.

Dervish Çadraku ka bërë pyetjen për paralelen e ndarë për shkollën fillore "Skender Kastrati" në Gexhë, që kam qenë disa herë në atë shkollë e që sigurisht do të shkoj prapë, nuk jam shumë i sigurt sepse nuk e kam këtu drejtorin e DKA-së se a është në këtë kontratë për renovim të shkollave ku gati edhe ka dështua ai Isa Dekori, në qoftë se jo atëherë ne kemi plan për renovimin e shkollave edhe besoj që për sivjet nuk kemi çka

flasim, por besoj që plotë shkolla të cilat kanë nevojë ose kanë pasur nevojë, disa janë riparuar dhe disa të tjera do të riparohen dhe po besoj që shkolla në Gexhe apo paralelja e ndarë nuk ka me mbetë jashtë kësaj, ju e dini se është ndërtuar me donacion të arabëve menjëherë pas luftës edhe sigurisht që nuk ka pas ndonjë investim pastaj edhe ajo ka ardhë duke u dëmtuar edhe demoluar. Rishikimi i lejeve të lokaleve që shfrytëzojnë hapësirat publike të trotuareve që ka pyetur Munibi edhe e ka ngritë këtë çështje, te pengesat në trotuare ose ata të ashtuquajturat topat e basketbollit, të këto pengesat tash e ka justifikuar qëllimin se për çka janë vendos dikur. Ju e dini se ka qenë projekt i përbashkët i Komunës dhe i Komisionit Evropian, edhe ne jemi të interesuar me bë ndonjë zgjidhje me atraktive kuptohet që ndoshta kanë me luajt të njëjtin rolë që me u mbrojte trotuari dhe me i shërbyer vetëm këmbësoreve por ndoshta do të hiqen këta dhe do të vendoset diçka tjetër por besoj që po se edhe unë personalisht jam i interesuar edhe e kemi ngritë këtë çështje sepse tash kanë kaluar 6-7 vjet edhe ka nevojë me i dhënë pak shije me të mirë. Rishikimi i lejeve të lokaleve- sigurisht që ne mundemi me bë këtë punë, ju kam thënë edhe më herët se tani kemi angazhuar pra kemi edhe auto bartje, unë nuk mundem me than se jam shume i kënaqur me punën e policisë për sa i takon këtij aspekti edhe këtij shqetësimi, auto bartja nuk vepron pa veprim të policisë pra veprimi i auto bartjes ndodh vetëm pasi vepron policia. Unë kam menduar, ne mundemi me i thënë auto bartjes shkoni dhe bëni punën tuaj, në qoftë se ka veprim aksion policia atëherë auto bartja është e gatshme, atëherë nëse nuk thirr policia atëherë ajo nuk është edhe kam përshtypjen dhe keq është me than kështu sepse unë nuk e komandoj policinë por kam përshtypjen se ka njëfarë sabotazhi të heshtur sepse edhe në këtë sallë disa herë edhe ne KKSBB edhe te Policia unë kam kërkuar së paku pavarësisht pasojave me vepruar në rrugën Gëzim Hamza- Piktori, me vepruar në rrugën Xhelal Hajda –Toni, disa herë kam thënë se po flenë makinat me javë në trotuare dhe adresa e përgjegjësisë është Policia e Kosovës edhe përsëri kemi kërkuar veprim sepse ka pasur shqetësim në debate publikë sidomos në rrugën Gëzim Hamza, ka trotuare të cilat bllokohen, lokale të cilat përpiqen me tejkalua lejen e shfrytëzimit të hapësirës publike dhe unë kam përshtypjen që këto situata ne duhet që me i trajtua ma me kujdes sepse ne duhet me i pa tani edhe njëherë ndoshta lejet që janë lëshua për 20 vite p.sh. edhe me pa a mos ka ndonjë gabim diku. Ne i kemi dy apo tri raste që kemi vepruar por ju e dini se ne rrugën nga gjimnazi ka dy shkollat e mesme ka shume telashe me frekuentim të makinave por edhe ne rrugën kryesore Xhelal Hajda- Toni, pastaj ne rrugën Sheh Myhedini ka njëfarë uzurpimi të trotuareve edhe njëfarë mosveprimi të policisë, tash policia e ka shumë më lehtë sepse e ka edhe auto bartjen. Ali Zhuniqi ka pyetur për konkursin në Arsim, me thënë të drejtën nuk e di, sigurisht nuk jam ne dijeni të kësaj çështje por logjikisht po them se ka mundësi me qenë duke punuar dikush edhe me u bartë apo me u plotësua ndonjë orë, nuk kam ndonjë informatë rreth kësaj çështje, ju kisha lutur që t'i drejtohuni drejtorit të Arsimit në email apo ndonjë forme tjetër dhe po besoj që do të ju jep përgjigje. Te plani i mobilitetit dhe zbatimi i tij, ne parashohim me pas zgjerim ose ndalesën në rrugën Xhelal Hajda – Toni, në rrugën kryesore edhe nuk besoj që do të ketë ndonjë ndryshim esencial prej planit të mobilitetit që ka kaluar në Kuvend, bile sivjet kemi planifikuar me i hy asaj teme mirëpo nëse kalon buxheti qysh dimë ne, e kam fjalën për buxhetin ne Parlamentin e Kosovës atëherë ne kemi mundësi me i dhënë zgjidhje serioze plot situatave që lidhen në qytetet edhe ne fshatra sepse i kemi formua kodet, kanë kaluar nëpër të gjitha fazat, e tash qeveria e re nuk i prek dhe nëse i prek atëherë mundet me na dëmtuar edhe neve edhe ndonjë komune tjetër, por nuk po besoj që do i prek sepse i kanë kaluar të gjitha procedurat, e aty kemi mundësi pastaj me mjete të buxhetit të Kosovës me bo disa veprime pra investime serioze sidomos në infrastrukturën rrugore në qytet dhe në fshatra, hapjen e parkingjeve të reja të vendndalimeve të automjeteve e posaçërisht kemi hapësirë ne rrugën Xhelal Hajda-Toni. Hanalora Hoti ka pyetur për dekorimin në qytet, tenderi është hapur me kohë mirëpo është interesant sepse askush nuk ka konkurrua në fazën e parë dhe tash u deshtë me i pritë krejt procedurat për të rihapur edhe njëherë edhe pastaj me konkurrua. Ne kontratën e kemi lidhur me vonesë pra në krahasim me komunat tjera kemi qenë më vonë dhe në momentin kur ka filluar puna sepse ajo është kontratë dhe në momentin kur ka filluar puna, aty ka bërë dikush një fotografi edhe e ka shpërndarë edhe mirë ka bërë që e ka shpërndaje mirëpo ajo nuk ka ndikuar që tash ne me veprua jashtë kontratës. Pra ne kemi një kontratë dhe ajo kontratë pothuajse 80% është përmbyllë, edhe sot ka aktivitete për dekorim edhe pse me vonesë, nuk janë shumë e madhe e parave të ndara që mund të jenë mbi 6000 euro, vlera

e parashikuar është mbi 9000 euro por sa kanë hije me kontratë është shumë më poshtë pasi vlera e kontratës është shumë më e vogël, pasi unë kur i lëshoj urdhëresat natyrisht vlera e parashikuar mund të jetë mbi 100 000 euro por mund ta marrin po supozojmë me 70 000 euro pra kjo është kështu. Rruga Nëna Tereza e pa përfunduar që me siguri ka ndonjë problem apo mosmarrëveshje, nuk e di në detaje për shkak se nuk është këtu drejtori i Shërbimeve Publike për të na sqaruar, po ashtu edhe te përroi në Pataqan të Epërm, nëse e analizojmë atëherë përroi në Pataqan të Poshtëm është problem kurse në të Epërmin më pak, por ne situatën për trajtimin e përronjëve do të kemi në vitin 2020 pra do të kemi mundësi sepse ne sivjet kemi ndërhyrë në Pataqan të Poshtëm sepse i ka marr uji ata, fillimisht i kanë ndërtuar shtëpitë aty edhe e kanë mbyllë krejt edhe për herë të parë në historinë e Pataqanit të Poshtëm sivjet i ka marr uji sepse e kanë mbyll vijën edhe shtëpitë, i kanë ndërtuar nën nivelin e shtratis që e kanë mbyll edhe normalisht që ne kemi pasur telashe sepse janë krijuar dëme shtëpive që ishin të ndërtuara në mënyrë moderne, e di saktë edhe me emra sepse kemi formuar edhe komisione për vlerësimin e dëmeve. Pra në Pataqan të Epërm nuk është shumë problem sa është në Pataqan të Poshtëm. Te Procesverbalet që e kanë ngritur si çështje Rasimi dhe Munibi, në qoftë se ju jeni dakord që ne me i sjellë me CD-ja transkriptet që me i mbajte secili CD-në e vet edhe me i nxjerr konkluzionet, pra nëse ju doni ashtu atëherë me lehtë ju bie këtyre që e punojnë procesverbalin, ndërsa në procesverbal vërtet me qenë përmbledhje, konluza, konstatime, thelbi i asaj, pra CD-të mundeni me i marr secili asambleist nëse doni dhe ne mundemi me bë këtë punë por nëse nuk doni atëherë vazhdojmë kështu si e kemi pasur vazhdimisht. Unë nuk kam diçka tjetër, nuk po besoj që i kam mbetur dikujt borxh të përgjigjem në pyetjet e parashtruara.

Sali Sallteku – Përhëndetje për të gjithë, unë kam respekt për Munibin, por procesverbalet janë gjëra që duhet shkruar ashtu qysh thotë çdo kush edhe nuk është mirë më qitë ne votim hiq sepse ai që dëshiron me i lexua të gjithëve mundet me i lexua por të vetin duhet më patjetër sepse mund të manipulohet kjo sot edhe me arkivë mund të qohet gjithçka dhe unë jam për mos me prek aty hiq. Sa i përket trotuareve që e përmende kryetar, unë e pash një ditë që as Gjakova nuk kish auto bartje për me i larguar automjetet prej vendit, unë e di që tikitat Policia mundet me ju shkruar edhe nga të hyrat forcohet edhe buxheti, kryetari ka kompetenca që me ju thanë që të vendosen dënimet për shkelësit edhe pastaj pronari i makinës nuk e len aty, nuk pata diçka me politizua në këtë drejtim. Faleminderit shumë!

Fahrie Lushi – Faleminderit kryesues, unë mendoj që edhe Fjolla edhe çdo kush tjetër duhet me kuptuar se unë e drejtova një pyetje shumë me vend edhe për gjithë opinionin, nuk e kërkoja sqarimin personal ose nuk ke pyetje individuale ashtu si u kthye përgjigjja gati thuajse duke e recituar kështu që ai sqarim duhet me u marrë shumë normal edhe prej Fjollës, Kryetarit edhe gjithë secilit sepse ne jemi këtu për me i ditë të gjitha detajet edhe çdo paqartësi kemi të drejtë me parashtrua para juve, kjo ishte arsyeja e pyetjes përndryshe të mos krijojmë polemika e konspiracion mirëpo nga ana juve reaguat në atë drejtim kështu që e kërkoja vetëm për këtë arsye, nuk desha as polemikë e as konspiracion, veç desha sqarim për të gjithë opinionin jo vetëm për mua. Faleminderit!

Sali Sallteku – Faleminderit shumë Dervish që e ngrit këtë se përnime nuk kuptoni asgjë por nuk ka asgjë të keqe kjo, zj. Lushi nuk tha asgjë të keqe, këtë e kemi përcjell edhe e kemi parë, se si duket është keqkuptuar kjo tha se është mirë me dit, për shkak se reagoj ajo delegatja atje, për shkak se çdo gjë që kërkohet sqarim nuk duhet të keqkuptohet askush, kjo zonja kërkoi sqarim edhe nuk është mirë me reagua askush por atë sqarim desha me kërkuar edhe unë por megjithatë unë e kuptova shumë mirë se unë e dija se ajo Blerta Nalli e meriton dhe nuk ka asgjë të keqe edhe nuk tha askush diçka. Faleminderit shumë!

Ali Zhuniqi – Meqenëse u kthye drejtori, kisha kërkua sqarim lidhur me konkursin që nuk më është përgjigjur kryetari pak më parë. Është hapur një konkurs për shkak të pushimit të lehonisë që kanë shkuar dy zonja, një konkurs i Matematikës dhe për një konkurs tjetër që i përket lëndëve juridike, posedojmë informacione që vjen një profesoreshë dhe mban orë zëvendësuese në një lëndë të juridikut meqenëse i posedon këto informacione, lusim që të na tregoni nëse është e vërtete kjo apo jo dhe nëse është e vërtete pse pra nuk ka ndodh një konkurs edhe për lëndën juridike, ju lutem na tregoni arsyet nëse nuk ka diçka në këtë drejtim?

Avni Morina – Përshëndetje për të gjithë, është fjala për një konkurs i cili ka qenë në shkollën profesionale për lëndë juridike. Konkursi ka qenë i shpallur 15 ditë, nuk kemi pasur kandidat adekuatë përveç kandidatës që është pranuar, pasi që u mbyll procedura e konkursit e kam kuptuar që është e Prizrenit por prej kandidatëve tanë të komunës tonë nuk ka pasur asnjë që ka qenë adekuatë. Konkursi ka qenë për zëvendësim, ka pasur edhe kandidatë tjerë mirëpo nuk kanë qenë adekuatë dhe jemi detyruar me marrë kandidatin adekuat që është i profesionit.

Ali Zhuniqi – Se paku në bazë të kontrollës është parë që zyrtari që posedon komuna e Rahovecit nuk kemi hasur në informacionin në lidhje me këtë që ju thoni d.m.th. nuk kemi hasur në një shpallje publike për zëvendësim për lëndën juridike konkretisht profesor të juridikut për zëvendësim për shkak të shkuarjes në pushim të lehonisë së një zonje ndërsa në lëndën e Matematikës ka pasur d.m.th. këtu është problemi pse nuk ka pasur një shpallje publike në web-in zyrtar të komunës së Rahovecit dhe përderisa nuk ka atëherë kjo i bie në kundërshtim edhe me shpalljen publike që bëhet për zëvendësim ose për konkurse tjera, ne rastin konkret është edhe në kundërshtim edhe me këtë sa i përket kornizës ligjore të cilët shpallen për një vend punim.

Avni Morina – Konkursi ka qenë i shpallur publikisht edhe në faqe të komunës, a e kanë shpall atje departamenti nuk e di mirëpo edhe në tabelën e shpalljeve ka qenë 15 ditë afati i aplikimeve dhe faktikisht u pranua ajo që ka qenë adekuate, konkurrentë të tjerë nuk ka pasur d.m.th. adekuat e kam fjalën, tash nuk e di çka ka të paqartë këtu. Konkursin e kemi shpallur të njëjtën ditë që është në tabelën e shpalljeve dhe të njëjtën ditë e kemi dërguar për shpallje edhe në faqe të komunës.

Ali Zhuniqi – Absolutisht nuk kisha kundër asgjë sa i përket kësaj, nëse dikush ka pasur drejtimin adekuat për me zëvendësua, kur është vend punim i cili nuk ka drejtimin adekuat atëherë mundet me shkua edhe me një drejtim tjetër që i përshtatet që ka fillua të jetë edhe si dukuri e zakonshme por nuk ishte çështja të drejtimi që ka pranua, çështja ishte të përputhshmëria e afateve ligjore dhe tek shpallja e konkursit në web-in zyrtar. Tash unë i kërkoj drejtorit nëse kjo është e vërtetë pra nëse kjo nuk është shpallë edhe bien në kundërshtim me kornizat ligjore, a do ta shkarkoj drejtorin i arsimit, profesoreshën në fjalë nëse ka bërë një kontratë e cila nuk i përket kornizave ligjore.

Rexhep Oruqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin, për ju dhe gjithë kolegët asamblastët. Unë po e hapi një çështje të cilën gati e harrova, pasi është kryetari këtu do të bëjë një pyetje, pasi na keni mbetur borgj krenjtë kolegëve asamblastët për mëditjen e mbledhjes konstituive kur e kemi mbajtur mbledhja e parë e kuvendit, unë isha më i vjetri dhe e kryesosha mbledhjen, mëditjet nuk na keni paguar asnjërit prej asamblastëve, a ka shanca të mos na mbeten borgj se dhe ashtu pagat janë minimale dhe dikush me atë pagë po jeton, që të bëni diçka në këtë drejtim dhe mos me i lënë anëtarët e kuvendit pa kompensim dhe e dyta si aksionar i stacionit të autobusëve, në atë komision 3 vota ishim dhe kemi 4 apo 5 mbledhje dhe askujt nuk i rre ne mendje që të paktën gjysmë mëditje me na dhanë, pra punuam mbi 3 muaj dhe asgjë nuk na u dha, në ende jemi në atë komision si aksionar. Faleminderit për vëmendje, pyetja ishte për ju Kryetar!

Munib Durguti – Atëherë kryesues unë e tërheqë këtë propozim, nuk jam konsultuar as me grupin e as me të tjerët, besoj që qëndrimi i shumicës është me mbetet ashtu siç ka qenë, megjithatë unë mendoj pak me ndryshe mendoj se është procesverbal apo transkript voluminoz. Kam dashtë me thjeshtua edhe punën e zyrtarëve të kuvendit, e di që kjo nxjerr debate në secilën seancë, kam folur me shumë e ke shkruaj me pak, andaj le të jetë ashtu siç ka qenë, e tërheqë propozimin. Ju faleminderit!

Sali Sallteku – Faleminderit, unë veç desha me falënderuar se më të vërtetë kam mirëkuptim me Munibin, kështu që pa keqkuptime sa i përket kësaj.

Kryetari – Unë nuk kisha informatë Baca Rexhë, se nuk është paguar prezenca në seancën konstituive edhe pse sipas logjikës time, tash nuk e di ju ndoshta keni mendim ndryshe, seanca konstituive konsiderohet kur konstituohet, tash nuk e di dhe nuk jam i sigurt por do të flas me Afrim Limanin rreth kësaj, çështja të komisionet kuvendi ka vendos me i paguar mëditjet e anëtarëve të komisionit edhe duhet me shiku pse ka ndodhë kjo edhe a ka ngelë edhe ndonjë komision tjetër jo veç të stacioni i autobusëve që janë aksionar por edhe ndonjë komision tjetër. Unë po besoj që janë obligim që burojnë prej vendimit të kuvendit të komunës, por tash mos pritni se është mbyllë sistemi por kjo nuk do të mbetet në harresë për shkak se ka plot këtu secili

prej juve që është me ndonjë komision edhe unë e di që ka obligim me pagua, ndoshta është keq që dikush u pagua e dikush jo, unë do të analizoj këtë dhe do të shoh, për momentin nuk e kemi këtu drejtorin e financave mirëpo ai do të vjen pak me vonë. Faleminderit shumë

Kryesuesi – Gjithsesi faleminderit shume kryetar dhe gjithë të tjerëve, kalojmë ne pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i raportit rreth aktiviteteve të KKSB-së për vitin 2019.

Kryetari – Faleminderit shumë, raportin ose procesverbalin e takimeve, të gjitha takimeve të KKSB-së e keni para vetes, unë po besoj që ju keni pasur rast ose mundësi me lexua, besoj që procesmbajtësi i ka qëndruar besnik diskutimeve por edhe konkluzave që kanë dal nga çdo takim i KKSB-së ku kanë qenë prezent të gjithë anëtarët, policia, përfaqësuesit e ushtrisë edhe anëtarët e tjerë. Ne i kemi përmbushur planet sa i përket takimeve të KKSB-së, është zbatuar tërësisht plani që kanë dalë prej Kuvendit të Komunës pra që është votuar në Kuvend të Komunës edhe besoj që edhe në këtë mbledhje ndoshta e kemi një plan për vitin 2020 ku do të diskutohet dhe aprovohet nga Kuvendi i Komunës. Faleminderit shumë!

Rexhep Oruqi – Faleminderit kryesues, unë edhe raportin e punës por edhe planin e veprimit jam munduar me lexuar me vëmendje, këtu edhe janë paraparë edhe janë kryer disa raportime periodike por edhe janë paraparë në mënyrë stereotipe të njëjtat dhe veç po përsëriten prej viti ne vit. Unë kam vërejtur një dukuri që nuk është përfshirë këtu dhe që është mjaft shqetësuese jo vetëm për kuvendin por për gjithë opinionin e komunës, askund nuk është paraparë si pikë e veçantë një informatë se paku që t'i informoj Kuvendi për gjendjen e përdoruesve të mjeteve narkotike, ne jemi dëshmitarë dhe me vjen keq që nuk është prezent një përfaqësues i stacionit policor këtu dhe nëse është i kënaqur me komitetin për politike dhe financa është diçka tjetër por kuvendi duhet në mënyrë burimore me u informua se këta janë bartës të çështjes së sigurisë dhe është deshtë sot me kërkuar raportimin prej tyre, Kryetari e ka një punë dhe ky nuk mund të merret me çështjet e sigurisë në bashkësi e komunitete, ata janë përgjegjës dhe kanë informata, thjesht po dëgjojmë prej opinionit pra qytetarëve që bastisje të shpeshta po bëhen në gjithë komunën pra në qytet dhe nëpër fshatra ku janë aktive lokalet me muzikë të natës, aty përdoret te gjitha llojet e mjeteve narkotike edhe ne si Kuvend duhet të jemi të informuar dhe çka duhet të ndërmerret dhe të parandalohen ose me e zbutë së paku, unë nuk pash as në planin e veprimit për vitin 2020 dhe një gjë e tillë kemi nëpër shkolla sidomos në shkollat e mesme që veç në mëhallën time janë te burgosur mbi 5 dhe i mbajtën 2-3 dite dhe i lëshuan përsëri, policia është deshtë një raporte edhe kësaj pike. Faleminderit!

Kryetari – Sipas ligjit kryesuesi i KKSB-së jam unë, pra është Kryetari i Komunës dhe raportimet deri ne detaje të komandantit të policisë janë në çdo takime ai shpjegon me shifra edhe me detaje dhe ka për obligim se cila është gjendja konkrete e krimit individual, krimit të organizuar, përdorimit të narkotikëve edhe dukurive tjera të cilat paraqesin shqetësime serioze për qytetarët. Ne dakordohemi këtu që ta ftojme komandantin, unë mundem me ftua si kryesues edhe në emër tuajin edhe ne Janar me ardhë edhe me tregua për aq sa i lejohet sepse ai nuk i raporton kuvendit të komunës dhe nuk i raporton as kryetarit të komunës ne kuptimin me emra, baca Rexhë po besoj që po kuptohemi por për statistika, për shifra, për detaje meqenëse edhe unë i kam krejt ne disponim ata natyrisht ne baza ditore këso aktivitete pastaj kanë ndërveprim edhe me institucione tjera krimet e renda, policia rajonale, policia speciale e plot mekanizma tjerë, besoj që në janar ne mundemi me i propozua me ardhë me qenë pikë e rendit të ditës. Informate nga komandanti i stacionit të policisë në Rahovec kapiteni z.Fazli Morina, natyrisht ata duhet me marr njëfarë pëlqimi në zingjirin e vet komandues por besoj që për aq sa i lejohet ai ka me than atë para kuvendit dhe për aq sa ju keni nevojë ma individualisht diçka ju mund të i bëni pyetje me shkrim ku specifikisht mundet me ju përgjigje edhe për ndonjë detaje me shkrim. Unë vazhdoj të qëndroj në pikëpamjen edhe jam i bindur se gjendja e sigurisë në komunën e Rahovecit është e mirë, stabile dhe nuk ka probleme të cilat kishin me prish momentumin e sigurisë, stabilitetit e te tjera, ka veprime edhe të luftimit të krimit të organizuar, plaçkitjeve të armatosura të

cilat ndoshta e ka krye plaçkitjen këtu dhe nga këtu ka shkua në Prizren, Dragash dhe prej aty në Ferizaj d.m.th. i njëjti ekip mirëpo disa janë shpartalluar, disa janë kapur. Edhe te narkotikët ju e keni parë se siguria në shkolla, monitorimi i procesit mësimor janë në vazhdimësi pika shqetësuese që diskutohen dhe nxirren konkluzione dhe natyrisht janë edhe plot detyra të policisë e detyra të mekanizmave tjerë që ndërmarrin por nëse jeni dakord unë e ftoj zyrtarisht në emër të tuajin me ardhë në Kuvend edhe e qesim pikë të rendit të ditës për një informatë ose të themi një njoftim mbi gjendjen e përgjithshme të sigurisë dhe stabilitetit në komunën e Rahovecit ku informon komandanti i stacionit të policisë.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, ne përpara e kemi këtë raport dhe shohim se janë mbajtur gjashtë mbledhje, sipas planit e tha edhe Kryetari do të thotë është përmbushur ajo, gjithashtu çështjet të cilat i ka shqyrtuar ajo KKSBJ-ja mendoj se janë të interesit që prekin rendin, qetësinë publike mirëpo te pjesa konkluzat nuk ka sqarime për të gjitha këto çështjet do të thotë ka mangësi dhe ne si kuvendarë nuk jemi bash mirë të informuar mbi gjendjen rreth atyre çështjeve që janë shqyrtuar dhe pak a shumë edhe baca Rexhë e ceku për atë çështjen e përdorimit të substancave narkotike, unë konkretisht kisha me përmend çështjen e qenve endacakë dhe dua të di nga ju Kryetar se si komuna jonë i menaxhon qenët endacakë duke ditur se është problem edhe për qytetin edhe për fshatrat, e kemi raste goxha shumë në institucione shëndetësore që kemi kafshime të qytetareve tanë nga qenët, nuk është ndonjë statistikë shumë e madhe por megjithatë ka raste mirëpo mua po me intereson si menaxhohet tash pash këtë vit si është menaxhuar kjo çështje duke e ditur se me përpara ka qenë ajo forma brutale e vrasjes së qenve pastaj ajo është anuluar dhe ka ardhur forma tjetër përmes këtyre strehimoreve mirëpo nuk kam informata por për hir të opinionit që me ditë se si po menaxhohet tash çështja e qeneve endacakë në komunën tonë dhe për këtë kisha deshtë një sqarim më tepër. Faleminderit!

Dervish Çadraku – Faleminderit Kryesues, gati që u tha gjithçka që u deshtë me thanë por megjithatë pasi kam marrë fjalën po më intereson interesimi i këtij raporti, a ka qenë i fokusuar edhe te këta narkotikët sepse ju Kryetar keni thënë se i keni të dhënat ato çka i ka komandanti i keni edhe ju shumicën e të dhënave, a ka statistika se ky është problem i Kosovës pra problem kombëtar përdorimi i narkotikëve nëpër shkolla, a kemi apo nuk kemi ne përdorues nëpër shkolla pasi kjo ka shumë rëndësi për ne edhe deri sa këtu nuk është e theksuar u deshtë pa insistimin tonë se është problem shumë i madh, po aq sa përdoret armatimi pra armët pa leje e keqpërdorimi i plot seneve tjera që thatë edhe ju deri te thyerja e lokaleve tjera edhe kjo është po ashtu problem i rëndësishëm, ne nuk e kemi këtu të potencuar si statistikë se sigurisht se shkruhet me emra e mbiemra se kush janë ata, rëndësi ka për neve si komunë me ditë cila është statistika, e kemi këtë problem apo nuk e kemi ne si Rahovec dhe nëse kemi të bëjmë përjashtim kështu që është mirë që desha me forcua edhe fjalën e parafolësve që është e domosdoshme një raporte me u dhanë këtu për me pas njohuri të përgjithshme prej juve. Faleminderit!

Kryetari – E para, se qenët endacakë ju e dini se në vitin 2018-2019 janë trajtuar përmes AVUK-ut (Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës) përmes kontratave që ata i kanë lidhë me kompani private kompetente për këtë çështje. Natyrisht ato kanë operuar edhe në komunën tonë, ne mund të themi se nuk jemi ne përgjegjës pra ne jemi përgjegjës se kemi qentë gjithkund dhe në çdo vend bile edhe në qendër të qytetit po ashtu edhe në oborr të komunës po hyjnë e mos të flasim nëpër fshatra. Por, sa unë jam i informuar në cilësinë e Kryetarit të Komunës, ata janë vaksinuar dhe janë trajtuar me kapacitetet që i kanë pasur ata të parapara me kontratë dhe natyrisht është i ndaluar ekzekutimi i qenve endacakë pra tani nuk funksionon bile ne kemi pasur këtë shqetësim edhe me Policinë se a mundemi me gjete ndonjë modalitete por faktikisht duhet me shkel ligjin për të vepruar dhe kjo është e ndaluar për shkak të mbrojtjes së shtazëve nga shoqatat e ndryshme, pra vazhdon nga AVUK-i qenve endacakë, kjo është natyrisht edhe përgjegjësi morale e jona por neve nuk na ka dhënë mundësia me veprua me kompetencë për shkak se nuk jemi kompetentë. Dikush prej juve mundet me shtruar pyetjen se pse dy komuna tjera kanë marrë iniciativa, me gjasë Prizreni dhe Prishtina kanë bërë diçka në këtë drejtim, me siguri shtesë diçka kanë angazhuar veterinarë se ndoshta kanë planifikuar edhe buxhet ose

kanë buxhete shumë më shumë ndërsa neve na është pamundësuar jo vetëm për shkak të buxhetit por edhe për shkak se këto kompetenca kanë qenë të nivelit të AVUK-ut që ka kontraktuar dy kompani që i trajtojnë në rajonin tonë qentë endacakë. Unë besoj që Kuvendi i Komunës është i vetëdijshëm se Policia nuk i raporton Kuvendit të Komunës, ju në këtë raporte, ky është një përmbledhje e takimeve, konkluzave, debateve thelbësore të takimeve të KKSB-së përndryshe procesverbalet e KKSB-së kjo vlen për të gjithë, hyni në faqen zyrtare të Komunës dhe aty keni statistikë deri në detaje, sa ka kriminalitet në komunë, sa ka vjedhje, sa ka tiketa, sa ka gjobitje, sa ka kundërvajtje të gjitha i keni në procesverbalet e gjashtë takimeve të KKSB-së të publikuara në web-faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit. Ato që policia i raporton Kryetarit edhe që janë biseduar në KKSB i keni por në KKSB nuk përmenden me emra sepse edhe policia nuk i parasheh me i përmend rastet konkrete që kryesisht janë me iniciale por ato që janë diskutuar thelbësisht në KKSB i keni në web-faqen zyrtare. Edhe njëherë po e them mënyra më e mirë është Komandanti i Stacionit të Policisë me dhënë informatë ose njoftim për gjendjen. Për sa i takon lokaleve të natës ju kisha lutur, unë jam duke shqyrtuar mundësinë bashkë me Policinë edhe me institucionet tjera me kufizua veprimtarinë e lokaleve të natës sidomos në ato vende ku ne i dimë ku janë pikat kritike, i dimë edhe pikat kritike ku janë të narkotikëve, nuk dëshiroj me i nda me juve se a ka tash narkotikë nëpër shkolla apo jo sepse nuk ma lejon edhe pozita por nëse ne marrim masa parandaluese përmes policisë dhe programeve të caktuara, të policisë në bashkësi dhe disa veprimeve tjera për me i parandalua narkotikët sidomos në shkolla të mesme, ne mund të kemi situata sfiduese të cilat ne si komunë dhe në fakt organet kompetente i trajtojnë, ata i trajtojnë me kujdes, ne nuk themi që nuk ka narkotikë në komunën e Rahovecit ose njerëz që merren me këto punë të pista mirëpo sigurisht që janë detyra të policisë edhe besoj që kemi marrë disa masa parandaluese në luftimin e dukurisë së shpërndarjes së përdorimit të narkotikëve, narkotikë ka edhe në lokale të natës ndoshta por janë pozicione që lidhen me krimet e rënda por sidoqoftë një informatë e komandantit të stacionit policor ku ju mundeni me bo pyetje pastaj ai e vlerëson sepse ai i raporton dikujt se çfarë përgjigje mundet me dhanë apo jo para kuvendit. Përndryshe mos pritni që procesverbalet me i sjell në Kuvend të Komunës sepse i keni web-faqe dhe nuk parashihet në takimet e KKSB-së me i sjellë procesverbalet sepse i keni të publikuara në web-faqe, raportin pra këtë që keni sot sigurisht por të gjitha procesverbalet e të gjitha takimeve.

Refki Kryeziu – Faleminderit kryesues, unë veç pata një propozim rreth gjendjes së sigurisë së përgjithshme në komunën e Rahovecit që të jetë një bashkëpunim i mirë i komunës me Policinë, të bëhet vendosja e kamerave të sigurisë nëpër disa pika kyçe të komunës tonë që të monitorohen online nga Policia në komunën tonë, që ka disa komuna tjera që veçse e kanë këtë sistem të monitorimit, besoj që ne një të ardhme do rrisin sigurinë në komunën tonë. Faleminderit!

Trajko Shariq – Unë deshta të ndërlihem me propozimin e zotërisë i cili tha për çështjen e sigurisë të vendosjen kamerat e sigurisë. Këto kamera ka mbi një vit që janë të vendosura në lagjen e epërme mirëpo nuk janë funksionale pra ekzistojnë kamerat mirëpo funksioni i tyre nuk është, serveri i atyre kamerave është në stacionin policorë.

Kryesuesi – Faleminderit shume, të nderuar kolegë kuvendarë, meqë nuk kemi edhe tjerë të lajmëruar për pikën e tretë, kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të veprimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2020

Kryetari – Faleminderit edhe njëherë, ju tash jeni anëtarë të Kuvendit të Komunës, besoj që është rast i mirë me propozua edhe ndonjë pikë të veçantë të rendit të ditës që mund ta bën edhe më të përmbushur planin për vitin 2020, unë besoj që ne duhet t'i kushtojmë vëmendje siç edhe po shihet edhe këtu aspektit të sigurisë se pa siguri nuk ka kuptim edhe jeta jonë edhe e atyre që vinë pas nesh. Mund të plotësohet edhe mund të jepen vërejtje, ide të reja, pika të reja të rendit të ditës që çështje të rëndësishme për diskutim për vitin 2020 sepse unë kam edhe një mbledhje për këtë vit me datën 30 të këtij muaji me KKSB-në ku do të shohim pastaj se do

të kemi një bilanc dhe ai bilancë ka me na ndihmua që edhe në mbledhjen e janarit kur të flasim pak më konkretisht. Ky plan është bërë në harmoni me përfaqësuesit e OSBE-së edhe me Policinë e Kosovës por edhe me anëtarët ekzistues të KKSBB-së. Natyrisht ky plan që të jetë edhe me i kompletuar duhet të diskutohet në Kuvend, të merren ide edhe nga Kuvendi edhe të miratohet pastaj në veprim sipas planit, mund të ketë takime të jashtëzakonshme urgjente të KKSBB-së atëherë ne kemi obligim me zbatuar planin e Kuvendit të Komunës për vitin 2019 të cilën e kemi votuar ju, madje edhe kemi dalë përtej kësaj për shkak se kanë dalë edhe situatat ndoshta nuk mund të parashihen ose nuk mund të planifikohen ose nuk mund të vendosen në kuadër të një plani të punës.

Kryesuesi – Faleminderit shumë kryetar, atëherë nëse nuk kemi tjerë të lajmëruar rreth kësaj pike qesim në votim pikën e katërt të rendit të ditës, konstatoj se unanimisht kalon pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit paraparak për shpalljen e interesit të përgjithshëm për hapjen e rrugës publike në zonën kadastrale Xërxë.-

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar Kryetar i Komunës, të nderuar kolegë drejtor, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, para jush kemi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelës me numër 55032 në zonën kadastrale në Xërxë. Kjo parcelë gjendet afër Zyrës së Vendi, afër shtëpisë së shëndetit pra bëhet fjalë për 2 ari 63m². Kjo parcelë është në bashkë posedim të pronarëve Bashkim, Lulzim dhe Shpejtim Sinani nga fshati Xërxë. Kjo parcelë e këtyre pronarëve privat para disa viteve është kubëzuar dhe aktualisht faktikisht atje në terren është rrugë e kalueshme prej pronarëve prej komunitetit të asaj lagje. Disa herë bashkëpronarët kanë kërkuar prej komunës së Rahovecit të bëjnë zgjidhje në bazë të ligjit për shpronësime ose këmbim gjithashtu ka pretenduar edhe me e mbyllë këtë rrugë, pronarët të cilët kanë qasje në këtë rrugë private edhe ata kanë pasur telashe prej pronarëve për shkak të njëjtë kanë deklarua në qoftë se nuk zgjidhet ky problem do ta mbyllin. Ne jemi tash në fazën e parë ku ligji parasheh që fillimisht para vendimit për këmbim ose shpronësim të shpallet kjo sipërfaqe zonë me interes të përgjithshëm prej Kuvendit të Komunës së Rahovecit. Ftoj kuvendarët që pas shqyrtimit të aprovojnë propozim vendimin që të shpallet kjo zonë me interes të përgjithshëm komunal.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, edhe në komitetin për Politikë dhe Financa, kemi trajtuar këtë pikë të rendit të ditës, ne jemi për propozimin e kryetarit që të shpallet interes i përgjithshëm publik parcela kadastrale me sipërfaqe prej 263 m², kur dihet se është interes i qytetarëve të Xërxës dhe do të ju shërbej për lëvizje të lirë, pra edhe në emër të grupit të PDK-së deklaroj se jemi për këtë shpallje të interesit të përgjithshëm.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z.Fazliu, nëse nuk ka tjetër dikush të lajmëruar, e qesim në votim edhe pikën e pestë të rendit të ditës, konstatoj se unanimisht aprovohet pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2019. –

Kryesuesi – Kuvendarë të nderuar, në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale, statutit të komunës, rregullores së punës të Kuvendit, po paraqesim para jush Raportin e punës së Kuvendit për vitin 2019. Në këtë vit Kuvendi ka mbajtur gjithsej 12-të mbledhje të rregullta duke përfshirë edhe mbledhjen e sodit, gjithashtu në këtë vit kemi mbajtur edhe një mbledhje solemne me datën 17.02.2019, për nder të 11-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ku në këtë mbledhje solemne është bërë edhe shpallja nga Kuvendi “Qytetar nderi” i z.Xhevahir Spahiu nga Shqipëria si dhe janë ndarë mirënjohje për ish Kryetarët e Komunës tonë, gjithashtu janë ndarë mirënjohje edhe për qytetarët të cilët kanë dhënë dhe kanë kontribuar për lirinë tonë si dhe në këtë mbledhje solemne është ndarë edhe mirënjohje post mortum për kolegun tonë z. Astrit Thaqi.

Të nderuar kuvendarë, Kuvendi ka të themeluar Komitetet të përhershme siç është Komiteti për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, gjithashtu Kuvendi ka të themeluar edhe komitetin konsultativ për

Auditim të Brendshëm kurse komitetin për shërbimet publike nuk është themeluar për shkak se ka dështuar konkursi ku nuk ka pasur të paraqitur konkurrentë ose aplikues dhe në bazë të rregullores nuk ka mundur me u themelua ky komitete tjetër konsultativ. Komiteti për Politikë dhe Financa i cili është edhe organi kryesor i Kuvendit merret paraprakisht me të gjitha çështjet që parashihen të shqyrtohen në Kuvend siç janë dokumentet fiskale dhe financiare, planet dhe dokumentet e planifikimit strategjik, kornizës vjetore buxhetore, afatmesme, planit vjetor të prokurimit si dhe marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve për mbledhje të Kuvendit. Të nderuar kuvendarë, edhe këtë vite Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) ka organizuar dhe ka mbajtur për dëgjimet buxhetore për vitin 2020, të cilat këto dëgjime i kemi filluar me datën 05.07.2019 dhe i kemi përfunduar me datën 17.07.2019. Të gjitha dëgjimet kanë qenë publike dhe janë mbajtur sipas orarit të paraparë në secilin vendbanim dhe lagje urbane të qytetit. Duke mos harruar të ceki që gjatë kohës së mbajtjeve të dëgjimeve buxhetore, nuk janë mbajtur dy dëgjime, pra dëgjimet e parapara me bizneset dhe në fshatin Hoçë e Madhe për shkak të mospjesëmarrjes së bizneseve, ku në atë takim kanë qenë të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa gjithashtu edhe në fshatin Hoçë e Madhe nuk ka pasur qytetarë. Kuvendi i Komunës gjatë këtij viti ka nxjerrë këto vendime: 6 rregullore, 9 plane, 43 vendime apo akte 12 njoftime apo informata si dhe 8 raporte, ku gjithsej në total i kemi 78 akte. Gjithashtu në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja e cila ka shqyrtuar të gjitha aktet apo vendimet e miratuara, na ka rekomanduar t'i rishikojmë dy vendime. Bazuar në këto rekomandime nga MAPL-ja, Kuvendi ka rishikuar dhe janë miratuar në përputhje me rekomandimet nga MAPL-ja. Rreth monitorimit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës tonë, edhe këtë vit është bërë nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, OSBE-ja, KFOR-i, OJQ-ve lokale, media si dhe është bërë transmetimi i drejtpërdrejt i të gjitha mbledhjeve nga web-site i komunës si dhe nga radio aktiv. Raporti i Kryetarit të Komunës për punën e ekzekutivit është bërë në 6-mujorin e parë në mbledhjen e Kuvendit në korrik kurse raporti i dytë do të mbahet në mbledhjen e ardhshme në janar kur edhe përfundon viti fiskal për vitin 2019. Të nderuar kolegë, mos të harroj të përmendi se këtë vit, Kuvendi ka aprovuar dhe kemi pasur edhe binjakëzimin me dy komunat Civita dhe Frosinete nga Italia si dhe është në proces të binjakëzimit me Bashkinë e Vlorës. Të nderuar kuvendarë, në këtë raporte është bërë prezantimi i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës tonë, për më gjerësisht që mos të ju marr edhe shumë kohë atëherë të gjitha para vetit e keni edhe raportin ku janë të shënuara pak më gjerësisht të gjitha aktivitetet të cilat i ka kryer Kuvendi. Faleminderit shume për vëmendje.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, fillimisht të përgëzoj për raportin që na ke sjellë, që është një raport mjaftë i kompletuar për të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur brenda vitit 2019 kështu që të falënderoj shumë, por meqenëse është si dokument janë dy lëshime teknike të vogla që janë, e kemi faqe 4, në komunën tonë është i themeluar Komiteti për, që dy here është e shkruar dhe duhet të hiqet njëra dhe gjithashtu i nderuari kryesues faqe 15, është aty dëgjimi buxhetor për vitin 2020 që është e vërtetë që i kemi mbajtur siç e ceket edhe ju në të gjitha lokalitetet por në atë paragraf te ajo fjalë e fundit ku thuhet Kryesuesi i Kuvendit në koordinim me Komitetin për Politike dhe Financa dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, organizojnë dëgjime publike rreth buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2020, është mirë me thanë ka organizuar dëgjime publike për vitin 2020 pra le të ceket qartë.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, ju e prezantuat raportin e kuvendit të Komunës për vitin 2019 dhe ne kemi materialin e shkruar, mendoj se raporti, forma, dizajni si është prezantuar është i qartë dhe janë të përfshira të gjitha aktivitetet që i kemi bërë mirëpo unë para se me kalua këtë raporte kam ndërhyje në faqe 13, në fillim te numri 40 thotë vendimi buxheti dhe KAB-i për vitin 2020-2022, ne e kemi shqyrtua këtë mirëpo nuk është miratuar, besoj që duhet të jetë një pasues këtu që nuk është miratuar sepse prezantimin tabelarë është për ato që janë miratuar, titulli është në fillim edhe tjetër ndërhyrja është mungon muaji 12-të në këtë raport, ju e keni thënë me fjalë mirëpo në raport me shkrim nuk ekziston edhe unë mendoj se është e pamundur me ekzistuar edhe muaji 12-të përderisa ne raportin e paraqesim një muaj më herët edhe besoj që

lind nëvoja që në të ardhmen, raporti të bëhet më vonë pasi të kryhet viti kalendarik pra pasi të kryhet edhe dhjetori ndoshta për janar, tash e kemi edhe planin për Kuvendin komunal për vitin e ardhshëm, dhe ne ndoshta në të ardhmen do ta kemi, këtë raporte ne e kalojmë me vërejtjet tona sigurisht, ndërsa në të ardhmen raporti është mirë me u prezantua pasi të kalon viti kalendarik kurse plani është diçka tjetër duhet të jetë edhe më herët.

Kryesuesi – Faleminderit shume z.Cena, atëherë pasi nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Planit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2020. –

Kryesuesi – Të nderuar kolegë, gjithashtu edhe për draft planin e punës së Kuvendit, ku edhe duhet të aprovohet në bazë të rregullores që Kuvendi duhet të ketë planë të punës për vitin tjetër që na vjen, ne me datën 5 të këtij muaji, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa në bashkëpunim me organizatën e OSBE-së kemi mbajtur një punëtori të cilën e kemi trajtuar këtë Drafte Plan dhe jemi dakorduar, i kemi hyrë muaj për muaj dhe i kemi shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës të cilët duhet me qenë muajt me radhë, duke përfshirë nga muaji janar deri në muajin dhjetor. Gjithsesi aty kemi pasur disa ndryshime të vogla kur ka qenë pjesa për rend të ditës për drejtorinë e Bujqësisë që të jenë disa raporte pra kohen, që nga muaji prill të kalohet në maj, gjithashtu kemi pasur edhe disa ndryshime të vogla edhe te Drejtoria e Arsimit e cila ka qenë edhe kërkesë edhe e drejtorit të Arsimit që të mos jenë informata por të jenë raporte, për shkak që në raporte përfshihen sqarime më të mëdha pra të hollësishme kurse kur po janë informata po janë të shkurta dhe jemi dakorduar gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa në atë punëtori por edhe drejtorët që kanë qenë prezentë që ta kemi këtë drafte plan të punës për mbledhjen të cilën sot e kemi.

Munib Durguti – Faleminderit kryesues, po ashtu plani i veprimit për vitin e ardhshëm është mjaftë i punuar mirë, ajo që dëshiroj me propozua është që ta kemi nga një raporte për secilën drejtori të ndarë në muaj d.m.th. prej muajit janar e deri në dhjetor, kuptohet që drejtoria e Financave raporton e fundit mirëpo secila drejtori të raportoj nga një seancë d.m.th. nga një muaj me raporte të plota dhe jo informata, ky është propozimi im.

Fehmi Hoxha – Faleminderit shume kryesues, ju përgëzoj edhe për raportin edhe për planin se bashku me ekipin të cilin e keni bërë, është gjithçka në rregull mirëpo disa herë me herët ne seancat e kaluara kanë ngritë një çështje që tani mund të inkorporohet në kuadër të planit dhe një qëndrim të marrim këtu. Komiteti për Politik dhe Financa sipas ligjit para çdo seance takohet, diskutohen mirëpo nuk merr rekomandime. Është e udhës që në të ardhmen Komiteti për Politike dhe Financa aty ku ka pajtueshmëri të del me rekomandime para Kuvendit, shume më lehtë do kalon çdo pikë dhe më e shpejtë do të jetë po që se ju keni pajtueshmëri për një çështje të cilën e diskutoni paraprakisht dhe ne do të diskutojmë do të thotë propozoj a duhet të vendoset si plan apo si qëndrim në të ardhmen, Komiteti për Politikë dhe Financa para çdo pike të rendit të ditës, Kryesuesi të na raportojë dhe të na informojë me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa. Kjo çështje shkon për miratim ose ka mospërputhje pra shumë do t'i ndihmon Kuvendit edhe në kohë edhe gjithë anëtarëve të Kuvendit për me marr vendime në të ardhmen. Sinqerisht i mbani ato takime mirëpo nuk e dimë se çka keni diskutuar dhe a jeni marrë vesh apo jo, përsëri këtu po debatohet prej fillimit pra propozimi është që në të ardhmen vitin e ardhshëm, Komiteti për Politike dhe Financa për çdo pikë të rendit të ditës paraprakisht te raportohet nga ana e kryesuesit, të informon se Komiteti ka marrë rekomandime pozitive apo negative ose ka mospajtime edhe gjithsesi do të diskutojmë por shumë më pak.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, tani për hir të informimit të delegatëve tjerë është e vërtetë që ne si KPF kemi marrë pjesë ne hartimin e këtij plani dhe ne mendojmë se atë pjesën kryesore e kemi kryer mirëpo kemi marr vendim gjithashtu që finalizimi i planit duhet të bëhet në mbledhjen e Kuvendit Komunal sepse edhe delegatët e tjerë kanë të drejtë me bë ndërhyrje ndoshta ne nuk jemi të përkryer me krye këtë punë me një takim apo me dy takime që kemi pasur edhe mbledhjen e KPF-së, që nuk e kemi shqyrtuar edhe aq, sepse nuk kemi pasur kohë, mirëpo ka qenë ajo punëtori, por nuk do të thotë ajo se me kalimin e kohës mund të vërejmë

edhe ne se ndoshta ka ndonjë lëshim ose ndonjë propozim shtesë, kjo mund të vlejë edhe për ne edhe për secilin delegat, kështu që delegati Hoxha ka të drejtë por kanë të drejtë edhe ata me ndërhyrje sot, kane pasur kohë me lexua dhe nëse është në rregull vetëm e kalojnë. Sidoqoftë unë vetëm kam marrë pjesë në punëtori, megjithatë një ndërhyrje të vogël kam edhe për sot, tek faqja e parë forma tabelare, në janar e cekëm edhe pak më parë Raporti edhe Plani, te pika 8 thotë: Miratimi i planit vjetor të punës së KKSB-së. Unë mendoj se ne planin sapo e aprovuam për vitin e ardhshëm të KKSB-së do të thotë është muaji dhjetor edhe është krejt n'rregull por raporti duhet të jetë në janar kurse nga mbrapa e keni Shqyrtimin e raportit të KKSB-së, kurse në dhjetor duhet të jetë plani sikurse që e thamë më herët pra duhet vetëm t'iu ndërrohet vendi pra në dhjetor të shqyrtohet plani kurse në janar shqyrtohet raporti. Te pika 8-të jo miratimi i planit vjetor por miratimi i raportit vjetor duhet të jetë pra për të ardhmen është fjala, për ndryshe ne posa i kryem ato, prape te janari në piken 3 ceket viti 2019, Informatë e Kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për vitin 2019 ndoshta do të duhet të jetë për vitin 2020.

Rasim Fazliu - Faleminderit kryesues, edhe unë gjithashtu kam marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti rreth planit të punës se kuvendit edhe e kemi dhënë kontributin tonë atje por edhe këtu pak po dua të kontribuoj, mendoj që në planin e punës së Kuvendit për vitin 2020 është mirë të futet edhe raportimi i njësisë së Auditimit të Brendshëm këtu. E dimë se njësia e Auditimit të Brendshëm nuk na jep neve llogari Kuvendit por unë qëllimisht po e cek që ajo neve nuk na jep llogari por tash po i drejtohem Kryetarit të Komunës që në momentin kur njësia e Auditimit të Brendshëm ja dorëzon materialin Kryetarit të Komunës pastaj Kryetari i Komunës kur t'i vjen rendi me ndonjë moment me na raportua për punën e njësisë së Auditimit të Brendshëm në përgjithësi siç ka qenë praktike edhe me përpara, kështu që është mirë të futet edhe kjo në planin e punës kurdo qoftë që është e nevojshme dhe e mundshme d.m.th. për punën që e kryen njësia e Auditimit me na raportua për të gjitha drejtoritë pasi krejt problemi është i tyre.

Kryetari – Ju e dini që edhe në mandatin e parë po ashtu edhe të dytin, me kënaqësi unë kam vënë pika të rendit të ditës për raport të Auditimit të Brendshëm për secilën drejtori edhe këtë praktikë e kam vazhduar edhe mandatin e dytë ndërkohë këtu është Ruzhdiu dhe Binaku se na u tërheq vërejtja nga agjencioni me siguri është me udhëzim administrativ, se ju nuk keni të drejtë me qitë në Kuvend raportin e Auditimit të Brendshëm. Për sa i takon çështjes që e ngriti Rasimi, unë me kënaqësi raportoј por raportin si të tillë me protokoll e që e kemi qit rregullisht, nga vërejtja që kishim nga agjencioni që nuk na lejohet, unë tani nuk po mundem edhe deri ne detaje me interpretua këtë, vetëm raporti i Auditorit të Jashtëm ose i Zyrës Kombëtare të Auditimit edhe atë pasi të publikohet, duhet me ju paraqit Kuvendit për diskutim, për vërejtje, për plotësime tjera. Njësia e Auditimit të Brendshëm është e vërtetë që i raporton Kryetarit të Komunës dhe unë në përmbledhje të raporteve ose thekseve të veçanta mundeni me shpalosë sepse unë mendoj se Auditorët e Brendshëm dhe të Jashtëm janë kontribut dhënës në punën e Kryetarit të secilit institucion edhe mirë që i kemi por me dërguar raportin si të tillë qysh e sjellin këta për secilën drejtori, neve na kanë rekomanduar se është e ndaluar, për një interpretim me të detajuar mund të na japin Zyra Ligjore mirëpo e di që na është thënë se ju nuk keni të drejtë me i publikua raportet e njësisë së Auditimit të Brendshëm madje as në web-faqen e Komunës së Rahovecit e as në Kuvend të Komunës, këtë informatë unë e kam dhe po të ishte ndryshe prapë do të përballem pasi nuk më mungon vullneti sepse unë jap vet vërejtje kur të ma sjellin raportin unë i shoh ku janë të metat mirëpo me gjasë raporti i Auditimit të Jashtëm, Rasim pra Zyra Kombëtare i shikon edhe këta të brendshmit dhe pastaj i merr të gjeturat edhe aty, konkluzat dhe rekomandimet aty.

Rasim Fazliu – Një sqarim për këtë çështje që të sqarohem, i nderuari Kryetar dhe i nderuari Kryesues, në bazë të punëtorive që kemi mbajtur dhe bashkë ishim në disa punëtori na është thënë që Kryetari për njësinë e Auditimit të Brendshëm duhet të raportoј, unë propozoj që Kryetari të merr prej organit kompetent me shkrim dhe ta sjellë këtu se a është e ndaluar dhe ne dakordohemi, pra duhet ta dimë me shkrim se nuk ka të drejtë Kryetari me raportuar para Kuvendit për Auditimin e Brendshëm edhe jemi dakord.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Fazliu, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar për pikën e shtatë të rendit të ditës dhe që u bënë disa sugjerime dhe vërejtje ato do t'i trajtojmë gjithsesi në planin e punës atëherë e qesim në votim pikën e shtatë të rendit të ditës, konstatoj se unanimisht aprovohet pika e shtatë e rendit të ditës, kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i raportit mbi realizimin e planit për vitin 2019 si dhe shqyrtimi i planit të punës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2020. –

Fehmi Hoxha – Singerisht tash këtu u diskutua, edhe më herët e tha edhe Kryetari, nuk i jepet raporti vjetor i punës njësisë së Auditimit të Brendshëm Kuvendit. Njësia e Auditimit të Brendshëm me ligj edhe me ligjin për vetëqeverisje lokale i jep raport vetëm Kryetarit. Është dokument sekret, këta janë këshillëdhënës për kryetarin, nuk publikohen pra është shkelje e ligjit dhe nuk bën assesi të jepet fare këtu. E përmendi Kryetari shumë mirë, i vetmi organ i cili është kompetentë për me auditu Auditorët e Brendshëm është Auditori i Jashtëm (pavarur), kështu që s'kemi nevojë me u marrë fare dhe largoni këtë edhe vitin e kaluar kemi kërkuar me u largua, nuk duhet të vihet pikë e rendit të ditës, çka ka me raportuar edhe ashtu janë këtu dhe e kam lexuar me vëmendje pra janë vetëm shifra dhe asgjë tjetër, nuk kanë të drejtë me publiku, këta janë këshillëdhënës dhe vetëm Kryetarit i lejohet.

Kryesuesi – Faleminderit shumë, gjithsesi është e qartë ajo, atëherë kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i raportit mbi realizimin e planit për vitin 2019 si dhe informatë mbi planin vjetor të Zyrës së Prokurimit publik për vitin 2020. –

Kryesuesi – Unë këtu nuk po e shoh që është zyrtari z. Astrit Mullaabazi, ndërkohë nëse ju pajtoheni kalojmë në pikën tjetër, atëherë kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës:

Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për vënien në debat publik të Planit Lokal për Veprim në Mjedis për vitin 2019-2024.

Rumir Zhuniqi – I nderuari Kryesues, i nderuari Kryetar, kolegë drejtor, kuvendarë. Komuna e Rahovecit përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit ka filluar hartimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis. Ne kemi përgatitë një draft lokal të veprimit në mjedis andaj kërkoj nga asambleja komunale që ta vendos në shqyrtime publik këtë plan pastaj pas shqyrtimit publik dhe marrjes së rekomandimeve nga ekspertë, individë, qytetarë, grupet e interesit atëherë do të sillet në Kuvend për miratim dhe diskutime.

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor, atëherë pika e dhjetë është aprovimi nga Kuvendi që të merret e drejta për debate publik.

Fehmi Cena – Faleminderit Kryesues! Ne kemi përpara materialin e planit lokal për veprim në mjedis edhe është mjaftë voluminoz, i gjerë dhe ceket aty që ka qenë grupi punues i cili ka punuar në këtë drejtim mirëpo ne po duam nga këtu këtë plan ta hedhim në debat publik në mënyrë që nëse do të ketë plotësim ndryshime nga publiku sigurisht ato janë të mirëseardhura mirëpo para se me qitë në debat publik, mendoj se duhet edhe njëherë ai grupi që ka punuar aty dhe kush është kompetent sepse të dhënat këtu nuk janë edhe aq të plota, për kohen ku jemi ne, si duket disa shënime janë marrë edhe më përpara. Në shëndetësi konkretisht në faqe 21, prezantimi nuk është i plotë sepse janë prezantuar institucionet shëndetësore QKMF, 6 QMF edhe 3 AMF e në fakt janë 7 AMF do të thotë ka lëshime këtu të dhënat, nuk janë të plota kështu që duhet të shikojmë edhe njëherë sikurse në shëndetësi, nëse edhe nëpër drejtori tjera ka lëshime atëherë kjo duhet të del si e plotë dhe jo të dal kështu e mangët d.m.th. mungojnë aty AMF-ja në pjesën jugore të qytetit nuk figuron fare, Hoçë, Brestoc, Xërxë, Radoste janë ndërtuar më vonë pra shënimet janë këtu të përdorura më herët këtu që kanë qenë, pastaj dy faqe më mbrapa kemi objekte të mbrojtura të propozuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport edhe këto shënimet janë të pakta të mëhershme, ne sivjet në pranverë e kemi shqyrtuar këtë çështje, unë së paku e kam ngrit çështjen e objekteve të trashëgimisë kulturore, na është prezantuar nga drejtoresha një listë shumë e varfër, kemi thënë se do të formohet një komision i cili do të del me i identifikuar të gjitha këto objekte që ne mendojmë së paku duhet të jenë në mbrojtje, ajo si duket nuk është bërë, përsëri është prezantuar

listat e vjetër, e mangët pra mungojnë shumë objekte që do të duheshin me qenë, kështu që unë mendoj që ky material duhet të jetë më i kompletuar para se të hedhet në debat publik ose nëse mendoni kështu ta leni atëherë ka me pas shumë ndërhyrje d.m.th. në këto dy dikastere unë kam vërejtur se ka shumë mangësi për të tjerat ndoshta i kanë vërejtur delegatet e tjerë. Faleminderit!

Rumir Zhuniqi – Po përgjigjem në pyetjen e Fehmi Cenës, ne kemi formuar me vendim të Kryetarit një grup punues dhe informatat zyrtare i kemi marr prej secilit anëtar, që kanë përfaqësues në secilën drejtori, tash me siguri informatat janë me të vjetra mirëpo ne do t'i përmirësojmë ato pa problem, por edhe ne shqyrtim publik ne e mirëpresim çdo rekomandim apo sugjerim që plani të përmirësohet dhe pastaj sillet në Kuvend këtu për miratim dhe finalizohet si i tillë komplet.

Kryesuesi - Gjithsesi drejtor, sot kërkohet vetëm aprovimi për me dal në debat publik dhe na me dhënë kontributin tonë gjatë kohës e cila i kërkon aty edhe i plotësojmë të gjitha ku kemi mundësi. Faleminderit shumë, më qe nuk ka tjetër të lajmëruar, e hedhim në votim pikën e dhjetë të rendit të ditës, konstatoj se unanimisht aprovohet pika e dhjetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për vënien në debat publik të planit komunal të veprimit për eficientë të energjisë për vitin 2019-2020.

Kryetari – Është po ashtu një plan që është hartuar bashkërisht me Gizin (Organizatën qeveritare gjermane) dhe kërkohet po ashtu ky plan me u aprovua për tu hedhur në debat publik e më pastaj do t'i nënshtrohet diskutimit përsëri në Kuvend dhe sigurisht me vërejtje, plotësime, ide aprovimi i tij. Pra, nuk është një projekt që ka ndodhur vetëm prej nesh, është mirë sepse mbi këtë bazë në qoftë se ne do ta kemi të miratuar pas kalimit të procedurave të debatit publik të Kuvendit e tjera, ne mund të marrim projekte jashtëzakonisht të dobishme në interes të eficientës së energjisë në objekte publike, në infrastrukturë publike etj. Pra kërkesa jonë, pasi drejtori Përparimi është në Pastasel atje, pasi po përpiqemi të bëjmë atje diçka për ujë të pijes, edhe nëse jeni dakord unë kisha kërkuar aprovimin për ta kaluar në debat publik edhe këtë pikë.

Munib Durguti – Faleminderit, unë kisha vetëm një sqarim në pikën 1 të propozim vendimit që thotë që ky është plani i veprimit 2019-2021, tash veçse viti 2019 kaloj e ky do të dal në debat në muajin e ardhshëm dhe deri sa i vjen Kuvendit për miratim do të vjen viti 2020. Është bërë me qellim apo është ndonjë lëshim apo gabim.

Kryesuesi – Faleminderit z.Durguti, e hedhim në votim pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës, konstatoj se unanimisht aprovohet pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës. Ishim te pika e nëntë te Shqyrtimi i raportit mbi realizimin e planit për vitin 2019 si dhe Informatë mbi planin vjetor të Zyrës së Prokurimit publik për vitin 2020.

Kryetari – Meqenëse më ka ra hise mua sot me i marr përgjegjësitë edhe të njerëzve kompetentë që punojnë nëpër zyra. Ju e keni një dokument para vetes ku janë kontratat dhe janë ecuritë e projekteve, te realizimi i kontratave, pagesave etj. Natyrisht që mbi këtë bazë është edhe informatë, tash ju e dini që qeveria komunale përgatitet për planin e prokurimit publik për vitin 2020 i cili po ashtu kalon në Kuvend të Komunës. Meqenëse e keni dokumentin në dorë para vetit, ju mund t'i shihni tabelat edhe në qoftëse ka dikush me thanë diçka ne jemi këtu, ndoshta nuk i di të gjitha në detaje por do të mundohem të jap një përgjigje të duhur.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, po të ishte zyrtari unë kam pasur mjaft të diskutoj por pasi që nuk është i pranishëm nuk kemi edhe çka me thanë, veç në shikim të parë të fjalës e parë këtu, gjatë këtij viti Zyra e Prokurimit ka proceduar 32 aktivitete të prokurimit e më vonë thotë deri me tani zyra e jonë ka lëshuar 86 kontrata d.m.th. numri i kontratave plus këto që nuk janë nënshkruar, pastaj kontratë që janë në pritje për tu lidhur etj. i tejkalon numrin e aktiviteteve pra këtu është një diskrepancë që duket se më pak ka aktivitete se punë që janë kryer edhe nuk e kuptoj se çka ka deshtë me thanë këtu por pasi që nuk është i pranishëm, kam edhe shumë gjera tjera për të thënë dhe po e mbylli me kaq për shkak se nuk ka kush me na dhënë përgjigje.

Ali Zhuniqi – E kisha kërkuar edhe herëve tjera një kontratë që vlera e parashikuar ka qenë 9000 euro ndërsa vlera e dhënë 8950 euro, për mbulim të hapësirave mediale. Një medium si Kosova Press që është një web që unë e kam vizituar dje dhe shoh që nëse është ai zyrtari ai që unë e kisha parë d.m.th. nuk e përcjell asnjë aktivitet të komunës në lidhje me vlerën që i është dhënë. Atëherë a kish pas mundësi me na dhënë ndonjë lloj

raporti meqë është një shumë jashtëzakonisht e konsiderueshme i dhënë këtij mediumi për mbulim të hapësirave mediale edhe një shumë tjetër që jepet po ashtu për mbulim të hapësirave mediale diku mbi 5000 euro, pse duhet me ju dhënë me shpenzuar dy kompani për të njëjtin veprim.

Trajko Shariq – Në rubrikën me numër 120 përndryshe projektet infrastrukturore me qëllim të rregullimit të infrastrukturës në lagjet ku jetojnë komunitetet jo shumicë, pra nuk është paraparë kodi se kush po investon në realizimin e këtij projekti siç janë 2,3 ,1 d.m.th. në këtë rubrikën 120 nuk ekziston numri se në bazë të cilit kod ka me u rregullua kjo. Është paraparë shuma e mjeteve mirëpo kodi nuk është i caktuar, këtë e kisha si vërejtje.

Kryetari – Tani nuk mund ta di saktë për projektet se sa ka një buxhet prej zyrës komunale për komunitete dhe kthim, i cili është i paraparë edhe ka vendim Kuvendi edhe natyrisht në këtë buxhet marrin pjesë edhe donatorët që janë si Syri Vizion apo donatorët e tjerë edhe të qeverisë, e që nuk është kodi këtu nuk e di pse, por besoj që është e qartë që Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim e ka buxhetin e vet edhe e ka kodin e vet. Për sa i takon medimeve, kontrata është me Kosova Presin, pra që është një mekanizëm, është transmetues që i lidh me krejt televizionet nacionale private e publike, ne kemi kontratë me ta dhe mund të mos e hargjojmë këtë kontratë ani pse është vlere. Sepse ne e thërrasim për disa aktivitete, e nëse nuk ka kontratë, atëherë mund të na kushtojë më shtrenjtë për shkak që vijnë me kamera dhe krejt mekanizmin. Arsyeja se pse kemi bërë këtë kontratë, për shkak se ne kemi nevojë si komunë me dal përtej kufinjve të komunës së Rahovecit edhe është një traditë që është mirë me u vazhdua edhe ne të ardhmen, nuk është ndonjë shumë e madhe që mund edhe mos të shpenzohet kjo por edhe mund të shpenzohet edhe brenda një viti. Pse e kemi Radio Aktivin në kontratën tjetër, për shkak se ata i përcjellin seancat edhe çdo aktivitet të Komunës së Rahovecit edhe është Radio lokale edhe është e vetmja radio lokale d.m.th. e kemi vlerësuar që nuk është ndonjë shpenzim le të themi 10-12 000 euro brenda një viti të dyjat me i marrë, në qoftë se aktivitetet të kësaj komune, seancat e Kuvendit Komunal dhe veprimet e institucioneve tjera të komunës shpalosen para publikut të Rahovecit dhe të Kosovës p.sh. ne sot kemi mundur me pas Kosova Presin që mjafton veç një telefonatë me ja bërë Shefi i Kabinetit dhe menjëherë vijnë këtu se paguhet sepse kanë kontratë mirëpo nuk i kemi thirr edhe nuk i thirrur veç ne raste kur ata e parashohin për ndonjë intervistë me bërë me kryetarin apo me drejtorët për me justifikua diçka, por kur të vijnë në grupe 4 apo 5 veta me kamera edhe me krejt mekanizmin e duhur ndërsa Radio Aktivin është vetëm lokale. Unë po dua të jem korrekt me ju, tash ajo ka kontratë me komunën, tash mos sukseset e dështimet i pritni prej Klan Kosovës e televizioneve tjera sepse me ata nuk kemi kontratë mirëpo për te lidhur kontratë me ta ndoshta të kushton 30 000 euro sepse këta e kanë gjetur njëfarë modeli të na i marrin neve 500 euro prej një storie mirëpo i shesin ndoshta 1000 euro te televizionet tjera dhe kanë kontratë me të gjitha televizionet e Kosovës d.m.th. këto qendrore që janë 21, KTV, T7, Tv Dukagjini etj. dhe ju e keni parë që plotë herë vinë mediat tjera që nuk paguajnë kurrëgjë, bile nuk e di kush i paguan me ardhë me e pa se a ka ardhur Kryetari me kohë në punë apo jo d.m.th. kështu gjërash të qesin boll edhe komunës tone pa i thirr hiq ata vijnë e këta me kontratë që i kemi vijnë për shkak se janë të kontraktuar, te jemi korrekt dhe mos prisni me na qortua Kosova presi as juve e as neve, pra Komunën nuk e shan sepse ka kontratën Kosova presi jo kurse televizionet tjera sigurisht që e bëjnë.

Ali Zhuniqi – Ne rregull, sigurisht se deri sa merr pare dhe është i kontraktuar natyrisht që nuk shanë por çështja është se nëse vërtet merren këto pare nga taksa pagesit e komunës së Rahovecit ajo është e detyrueshme dhe nëse jo ju duhet me obligua mediumin i cili të përcjell që pavarësisht veprimeve ditore që ti i bën si kryetar i Komunës ti bëhet thirrje eventuale në web-faqen portale dhe çka e zotëron, në mënyrë që edhe ti në një farë forme mundesh me qenë në qendër të vëmendjes për çdo aktivitet që e keni qoftë për mirë apo për keq krejt kjo varët prej teje por se paku karshi shumes që e merr ta ndjekë veprimin dhe aktivitetin e komunës së Rahovecit që të kontribuojë ajo edhe në medime tjera ku ta di unë qoftë për mirë apo për keq.

Fehmi Cena – Faleminderit, kërkoj edhe unë dy apo tre sqarime në këtë raport, kam vërejt se Zyra e Prokurimit ka kontraktuar disa projekte të cilat nuk janë paraparë në kornizën afatmesme buxhetore, ne nuk e kemi shqyrtuar atë, besoj që ju e dini pastaj kam vërejt gjithashtu edhe projekte që ata i kanë kontraktuar më shtrenjtë se sa buxhetin, ne e kemi paraparë në Kuvendin Komunal edhe tash shtrohet pyetja se a ka të drejtë

Prokurimi me hapë tender pra konkurs për një projekt që KAB-i nuk e përfshin ose Kuvendi Komunal nuk e ka aprovuar për këtë periudhë kohore të caktuar, a ka të drejtë që me kontraktua një kontratë me një kompani mbi çmimin, mbi shumën që ne e kemi paraparë, bile dallimi është shumë i madh, nuk është dallim i vogël, këtë sqarim kisha kërkuar edhe tjetër është edhe një projekt që është paraparë për shëndetësi, pra furnizimet në shëndetësi që është anuluar, kërkoj sqarim nëse ka mundësi sepse kemi pasur probleme tash së fundi sidomos reagencat në laborator kanë qenë të parapara me u ble, kemi qenë shume të varfër në QKMF sa i përket analizave laboratorike kanë munguar ndërkaq po shoh që tenderi qenka anuluar, më siguri edhe kjo është shkaku i asaj pse është anuluar, këto 2-3 sqarime nëse ka mundësi me na i dhënë.

Kryetari – Po është e vërtetë që ka projekte që tejkalojnë vlerën e parashikuar por me korniza afatmesme buxhetore dhe kjo më shumë shpreh planet tona ambicioze dhe luftën që duhet ta bëjmë edhe si Kryetar Komune edhe si Kuvend i Komunës me gjete donatorë, natyrisht që nga viti 2020 do të ketë kufizime, nuk mundesh pa pas mjete edhe pa i planifikuar mjetet mirëpo tani në gjithë Kosovën kështu është, jo që është e lejueshme mirëpo ne synojmë i përmbyllë dhe me gjet mjete edhe me i përmbyllë kontratat që janë shuma të mëdha se sa që kemi mjete ose që mund të planifikojmë mjete ne si komunë. Këtë përgjegjësi e kam marrë unë normalisht edhe secili kryetar komune kudo neper Kosovë, qoftë ai para meje apo ai pas meje marrin sepse dëshirojmë të punojmë nëse na lejon ligji kuptohet nëse nuk ka një sanksion, mund të kemi vërejtje nga Auditorët e Jashtëm edhe për këtë temë edhe që është e logjikshme. Për sa i takon kontratës për furnizime, në kemi probleme jo vetëm ne si komunë por gati çdo komunë ka probleme me OSHP-në pra si të shkon lënda ne OSHP është telashe, vonesat vinë edhe si rezultat i kësaj. OSHP-ja është një gjykatë e tenderëve, atje kur të ankohet dikush pastaj vonesat janë shumë të gjata, që ndoshta mund të shkon edhe dy vjet, kemi problem me atë institucion që është i vetmi kompetent me dhanë vendimin kur ka ndonjë ankesë. Ne nuk e kemi kaluar kornizën afatmesme buxhetore ndërkohe që kontratat janë lidhë ndërsa disa priten në të ardhmen me u lidhë me lënde të reja, normalisht ne kemi mundësi pastaj me operua më suksesshëm nëse kemi një mundësi me marr edhe prej institucioneve qendrore prej buxhetit të shtetit, kemi marrë mbështetje këtë vite, mundemi me marr edhe vitin e ardhshëm që është normale edhe me u zvogëluar obligimet kontraktuale, financiare mirëpo pse kemi lidhur kontrata të mëdha ne mundemi me i ndërpre punimet kur nuk ka mjete ose mundet me i ndërpre operatori. Këto janë të rregulluara me ligje mirëpo normalisht po luftojmë me pas sa më shumë aktivitete, sa më shumë investime sepse kërkesat e publikut pra të qytetarëve janë shumë më të mëdha se sa ne që mundemi me ju dalë përballë sepse ka kërkesa gjithkrah. Tash për sa i përket reagensëve edhe furnizimeve, unë nuk e di saktë por nëse ka kalua çështja në OSHP me sa e di unë po atëherë ne duhet me prit, fatkeqësisht duhet me prit edhe ne nuk e dimë kohën sa duhet me prit sepse nuk varet asgjë nga ne, prej momentit që shkon lënda në OSHP, të njëjtën kontratë e kemi edhe me deratizim, dezinfektim, dezinsektim, nuk e di ajo ka pasur ngecje edhe kjo ka pasur ngecje e rrugës katër korsi, ka ngecje edhe ne disa kontrata që në momentin që po shkojnë atje, atëherë po duhet me prit kur ta sjellin vendimin ata që të vazhdohet, të ndalet apo të nisët prej fillimit, kjo po besoj që është përgjigja edhe logjike edhe reale.

Kryesuesi – Faleminderit shumë Kryetar, të nderuar kolegë kuvendarë, unë dua të ju falënderoj të gjithëve për kontributin për vitin 2019 për të gjitha mbledhjet që i kemi mbajtur ku secili prej neve e ka dhënë kontributin konstruktiv, gjithsesi para se të përfundojmë mbledhjen, unë kisha deshtë që kështu si jemi të bëjmë një fotografi këtu në sallë të kuvendit për vitin 2019 dhe pas fotos ju ftoj të gjithëve për nga një kafe. Gjithashtu ju uroj festën e fund vitit juve dhe familjeve tuaja të ju sjellin sa më shumë harmoni e gëzime. Faleminderit shumë të gjithëve për punën që kemi bërë në Kuvend. Mirupafshim në mbledhjen e radhës!

Mbledhja përfundoj 13:30

01 Nr. 35/2020

Rahovec, 30.01.2020

Procedim bajtësi:

Agim Hoti

